



Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti juridik

Studimet postdiplomike – Cikli i dytë

Tema e masterit

***“VEPRA PENALE E KEQPËRDORIMIT TË DETYRËS ZYRTARE NË
RRETHIN E GJYKATËS SË APELIT NË GOSTIVAR PËR PERIUDHËN
2005-2016”***

Mentori :

Prof.dr. Ismail Zejneli

Kandidati :

Adem Sejdini

Gostivar, 2017

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I-rë

1. Kuptimi i veprave penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	7
2. Trajtime historike të veprave penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	10
3. Trajtime komparative të veprave penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	12
3.1. Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.....	15
3.2. Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.....	17
3.3. Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës.....	20
3.4. Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Kroacisë.....	23
3.5. Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Serbisë.....	25

KAPITULLI II-të

1. Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit.....	28
2. Keqpërdorimi i shërbimit zyrtar	30
3. Marrja e ryshfetit.....	32
4. Dhënia e ryshfetit.....	34
5. Falsifikimi i dokumentit zyrtar.....	39

KAPITULLI III-të

1. Roli i prokurorit publik në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare..	42
2. Roli i gjykatave në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	46
3. Roli i mas-mediave në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	50
4. Roli i policisë në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare.....	53

KAPITULLI IV-të

1. Pasqyrë statistikore për territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare.....	56
2. Analiza e aktgjyqimeve.....	61

LISTA E SHKURTESAVE

KP	-	Kodi Penal
LPP	-	Ligji për procedurë penale
ESP	-	Ekzekutimi i sanksioneve penale
EDB	-	Ekzekutimi i dënimeve me burg
ESM	-	Ekzekutimi i sanksioneve ndaj të miturve
DÇA/C-		Departamenti për çështje administrative-civile
KÇS	-	Komisioni për çështje sociale
KN	-	Konventa Ndërkombëtare
GREKO	-	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
AD	-	Ankesa dhe denoncime
LESP	-	Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale
SÇD/M-		Spektori për çështje drejtuese-mbikqyrëse
EMM	-	Ekzekutimi i masave mjekësore
EME	-	Ekzekutimi i masave edukative
OSBE	-	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
UNCHR-		Agjencia e Kombeve të Bashkuara për refugjatë
DASH	-	Departamenti Amerikan i Shtetit
GJS	-	Gjykata Supreme

DBE	-	Dënimi me brugim
QPS	-	Qendra për punë sociale
KRM	-	Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
KPRM	-	Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
KPrP	-	Kodi Procedurës Penale
LPPRM	-	Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë
KPPK	-	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPI	-	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KP	-	Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Serbisë
GJL	-	Gjykata e Lartë
GJK	-	Gjykata Kushtetuese
GJEDNJ	-	Gjykata e tëDrejtave të Njeriut
KEDNJ	-	Konventa e të Drejtave të Njeriut
GJNP	-	Gjykata Ndërkombëtare Penale
PE	-	Parlamenti Evropian

Hyrje

Veprat penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare janë shprehje e dobët dhe papërsosmërisë së shtetit, pikërisht segmentit funksional të tij të shprehur përmes personave zyrtar. Paraardhësit e tyre, me veprimet inkriminuese, realizojnë fitime vetanake dhe shkaktojnë pasoja tjera, Brenda dhe jashtë fushëveprimit të drejtës penale. Prandaj, si bashkëveprues të tyre në kryerjen e aktivitete, paraqiten dhe persona tjerë (p.sh.mitë-marrje), të cilët së bashku me ta, veprojnë në krijimin dhe ekzistimin e korrupsionit dhe formave tjera të paraqitjes së veprave penale kundër detyrës zyrtare. Korrupsioni si shprehje e degradimit të vlerave morale në shoqëri (Aristoteli, Montesquie) është një nga format e veprimit në goditjen e detyrës zyrtare, nga e cila punë e ligjshme varen mjaft mekanizma dhe postulate në të cilat qëndron e tërë shoqëria, nga e cila sërish, varet dhe mbrojta e tërë rendit shoqëror juridik. Kjo paraqitje patologjike, si një nga format goditëse ndaj detyrimit dhe detyrës zyrtare, aktuale dhe gjithëpërfshirëse, në realitet është anomali sistematike, ku interesi personal vihet mbi interesin shoqërorë politik të bashkësisë. Ajo nuk është gjë tjetër deri në devijimin e kryerjes së detyrimit normal. Detyrë zyrtare, të lirë nga voluntarizmi dhe nën sferën private (ashtu të keqpërdorur), është funksionim i shoqërisë *raison d'etre* si bashkësi e rregulluar dhe murrë para anarkisë. Prandaj veprat penale kundër detyrës zyrtare janë “serioze”, pasi që kryerësit e së njëjtit person zyrtar, si çdoherë (me rregull) duke vepruar me qëllim, duke reduktuar kështu efektivitetin e shtetit ligjor. Sistemi i kontrollit dhe detektimit të kësaj veprimtarie ilegale është i domosdoshëm si një aktivitet i rregullt në luftimin e krimit, si në nivelin e jashtëm ashtu edhe në atë të brendshëm, për të qenë efektiv. Si më lart është me rëndësi të madhe sepse personi zyrtar, në fakt, siguron, siguresat e sigurisë (policinë) dhe mbijetesën e rendit ligjor dhe ilustron të tjerët me sjelljen dhe profesionalizmin e tyre. Zbulimi i kryerësve të këtyre veprimeve llogaritet me atë që nuk janë të denjë për të bërë atë që po bëjnë. Këtë dukuri negative sociale aspak nuk duhet minimizuar, por e njëjti duhet kundërshtuar me vendosmëri dhe në mënyrë voluminoze duhet qasur çështjes që ajo përfaqëson, dhe e gjithë kjo me qëllim të detyrave që janë të domosdoshme për shoqërinë, i çliruar nga krimet e interesit të fituara personale dhe abuzimet e përfitimeve veprime të synuara kolektive. Legjislacioni i shumë vendeve, kështu dhe i vendit tonë, duke klasifikuar veprat penale kundër detyrës zyrtare në një kategori të veçantë, thekson rëndësinë e tyre.

Me ndryshimet në Kodin Penal të RM-së të vitit 2004, është vënë përgjegjësia penale e personave juridik (neni 28-a). Pos dënimeve, Kodi Penal i RM-së parashikon edhe mundësinë për dënimin me kusht si masë alternative që përbëhet në shtyrjen me kusht të kryerjes së dënimit me të holla dhe ndalesën për të kryer veprimtari të caktuar (neni 96-g), si masa të posaçme të konfiskimit të pasurisë dhe të dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve (neni 96-d).

Ligjvënësi maqedonas përcaktohet për sistem të thjeshtë të dënimeve dhe të masave tjera, me të cilat duhet t'u kundërvihet formave të reja të krimit korporativ (mashtimi i blerësve, korrupsioni, larja e parave etj.).

Ai është i përshtatur me konceptin kryesor në raport me personin juridik si subjekt i veprës penale, sipas së cilës dënueshmëria e tij bazohet në parimin e përgjegjësisë së supozuar (neni 28-a pika 1 e Kodit Penal të RM-së). Përgjegjësia e supozuar e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë dhe dënimin e personit fizik i cili është kryerësi i veprës penale, që do të thotë se është pranuar sistemi i përgjegjësisë paralele dhe i dënueshmërisë për një vepër të njëjtë edhe personit fizik (p.sh. drejtori) si kryerës direkt, nëse është fajtor për veprën e kryer, dhe personit juridik (nëse p.sh. pas kryerjes së veprës qëndron vendimi kolektiv i organit që e drejton (neni 28-a pika 2).

Sistemi i dënimeve për personat juridik e pranon faktin se si subjekte të veprës penale mund të paraqiten të gjithë personat juridik, me përjashtim të shtetit (neni 28-a pika 3). Sipas kësaj, llojet e dënimeve dhe përmbajtja e tyre duhet të jenë të aftësuara në atë që është e përbashkët për personat juridik, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për privat, shtetëror ose të përzier, sipas formës së pronës ose veprimtarisë që kryejnë.

KAPITULLI I-rë

1. Kuptimi i veprave penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare

Në literaturë hasim definicione të shumta në lidhje me këtë nocion, por këtu do të kisha shfrytëzuar definicionin e dhënë nga Svetlana N., ku me këtë nocion nënkupton: numër të drejtash dhe autorizimeve të personave zyrtar, përgjegjës dhe personave tjerë që kryejnë punë me karakter publik, të cilat autorizime i kanë marrë me zgjedhjen apo emërimin e tyre në funksione përkatëse, apo në ndonjë mënyrë tjetër ligjore i është përshkruar ajo veti. Me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë në vitin 1999¹ llogari për veprime kriminale të kësaj natyre u vendos që të japin edhe personat përgjegjës në persona juridik, edhe personat përgjegjës në persona juridik të huaj si dhe persona përgjegjës që kryejnë punë me karakter publik. Nocioni për përcaktimin e karakteristikave të veprave penale kundër detyrës zyrtare janë preambulë në kreun e ardhshëm të paraqitjes së formave të tyre, e cila shtrirje më së miri mund të tregohet përmes këtyre veprave, llojllojshmëria i tyre, si dhe instrumentit të penologjisë përmes të cilit ligjvënësit kundërshton të njëjtat.

Në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit” është i paraparë në nenin 353 në kreun XXX-të. Kjo vepër penale është e përbërë prej 5 paragrafëve edhe atë²:

(1) Personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës apo të autorizimit të vet zyrtar, me tejkalimin e kufijve të autorizimit të vet zyrtar apo me moszbatimin e detyrës së vet zyrtare do të përfitojë për vete ose për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetërkujt do t’i bëjë dëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

(2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë apo do të shkaktoj dëm më të madh të pasurisë, apo më të rëndë, do t’i shkelet e drejta e tjetër kujt, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në 5 vjet.

(3) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, kryerësi do të dënohet më së paku me tre vjet burgim.

¹Ligji për ndryshim dhe plotësim i Kodit penal të RM – së (Gazeta zyrtare e RM – së nr.80/99).

²Svetlana N., me këtë nocion nënkupton: numër të drejtash dhe autorizimeve të personave zyrtar, përgjegjës dhe personave tjerë që kryejnë punë me karakter publik, të cilat autorizime i kanë marrë me zgjedhjen apo emërimin e tyre në funksione përkatëse, apo në ndonjë mënyrë tjetër ligjore i është përshkruar ajo veti.

(4) Me dënimin nga paragrafi 1, 2 dhe 3 do të dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi apo kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë apo personi që kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës se tij të posaçme.

(5) Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 4 është kryer gjatë kryerjes së furnizimeve publike apo në dëm të mjeteve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga fondet publike apo nga mjetet tjera të shtetit, kryesi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Pra, në rastin konkret personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës apo të autorizimit të vet zyrtar, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet, derisa nga keqpërdorimet e fondeve publike ose mjetet tjera të shteti kryesi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Po qe se analizojmë paragrafët e lartpërmendura në veçanti paragrafin e parë mund të konkludojmë se kjo vepër penale paraqitet në tri forma dhe atë:

- Shfrytëzimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar;
- Tejkalimi i kufijve të autorizimit zyrtar;
- Moszbatimi i detyrës zyrtare;

Para se të sqarojmë format e shfaqjes së kësaj vepre penale, duhet të definohet nocioni pozitë zyrtare, mbase i njëjti nocion haset në të tri format e lartpërmendura.

Nocioni për përcaktimin e karakteristikave të veprave penale kundër detyrës zyrtare janë preambulë në kreun e ardhshëm të paraqitjes së formave të tyre, e cila shtrirje më së miri mund të tregohet përmes këtyre veprave, llojllojshmëria i tyre, si dhe instrumentit të penologjisë përmes të cilit ligjvënësit kundërshton të njëjtat. Shfrytëzim të pozitës zyrtare dhe të autorizimit kemi atëherë kur veprimi i kryerësit të veprës mbetet në kufijtë të autorizimit, por bën keqpërdorim të atyre autorizimeve në atë mënyrë që interesin zyrtar e zëvendëson apo ndërron me interesin e vet personal apo me interesin e dikujt tjetër³. Në këtë këndvështrim veprimi i kryerësit na paraqitet si joligjor në aspektin material e jo në atë formal, mbasi nuk kemi të bëjmë me tejkalimin e kufijve të autorizimit apo moszbatimin e pozitës apo autorizimit zyrtar. Shembuj tipik të kësaj forme të keqpërdorimit kemi në ato

³V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Shkup 2010.

raste ku personi zyrtar me autorizimin që posedon, për zgjedhjen e ndonjë problem ka në dispozicion disa metoda, dhe logjikisht si zgjedhje më e mirë do të ishte që ai te zgjedh mënyrën më të volitshme në interes të shërbimit përkatës. Në qoftë se i njëjti në zgjedhjen e metodës për zgjidhjen e problemit përkatës nuk udhëhiqet nga logjika për të mbrojtur interesin e shërbimit, por interesin e tij personal apo dikujt tjetër, me qëllim të përfitoj për vete ose për tjetër person ndonjë dobi ose tjetër kujt dot'i bëj dëm, me këtë veprim personi zyrtar bën keqpërdorim të pozitës zyrtare edhe pse në aspektin formal vepron në suaza të autorizimeve të tij.

a) Tejkalimi i kufijve të autorizimit zyrtar

Tejkalimi i kufijve të pozitës zyrtare dhe autorizimit vjen në shprehje atëherë kur kemi të bëjmë me veprim nga ana e personit zyrtar, i cili veprim ka karakter zyrtar por, edhe pse ka këtë karakter i tejkalon kufijtë e pozitës zyrtare. Pra nuk kemi tejkalim të kufijve në qoftë se veprimi i kryerësit nuk ka karakter zyrtar. Në literaturë ekzistojnë definicione të ndryshme për përmbajtjen e këtij nocioni⁴. Në bazë të autorit Lazareviq L., tejkalim të kufijve të pozitës zyrtare dhe autorizimit kemi atëherë kur personi zyrtar kryen veprime zyrtare, të cilat janë në kompetenca të personit tjetër zyrtar, dhe irelevante është pozita hierarkike e personit tjetër zyrtar që do të thotë se i njëjti mund të jetë me pozitë më të lart apo më të ulët në krahasim me personin zyrtar që ka tejkaluar kufijtë e autorizimit të tij. I njëjti autor thotë se kjo formë e keqpërdorimit vjen në shprehje edhe atëherë kur personi zyrtar kryen ndonjë punë zyrtare të lëmisë së vet, por për të njëjtën punë është dashur paraprakisht të sigurohet pëlqim nga person tjetër zyrtar apo organ tjetër. Pra edhe pse personi zyrtar ka kryer punën që bie në sferën e tij, në qoftë se paraprakisht për atë punë nuk është siguruar pëlqim prej organit përkatës, atëherë kemi të bëjmë me keqpërdorim të pozitës zyrtare të kësaj forme.

Vlen te theksohet edhe mendimi i Jovasheviq J. i cili thotë, se që të kemi tejkalimi të kufijve të pozitës zyrtare dhe autorizimit është e domosdoshme që paraprakisht personi zyrtar të kryej veprim zyrtar, i cili veprim në vete nuk është jashtëligjor, pasi dikush është i autorizuar për marrjen e këtij veprimi, por nuk është i autorizuar ai person zyrtar që e ka marrë këtë veprim. Pra, shohim se të gjitha definicionet në thelb nuk ndryshojnë shumë, dhe njëra tjetrën po e plotësojnë, kurse karakteristikë e përbashkët e këtyre për të konstatuar a bëhet

⁴Format e shfaqjes së veprës penale, keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Sadin Halili dhe Muazam Halili.

fjalë për tejkalim të pozitës zyrtare gjatë veprimit zyrtar, janë rregullat ligjore të parapara për atë lëmi si dhe autorizimet që posedojnë personat zyrtar konkret⁵.

b) Moszbatimi i detyrës zyrtare: Kjo formë vjen në shprehje atëherë kur personi zyrtar me vetëdije, nuk merr veprim zyrtar për të cilën është i autorizuar dhe ka për obligim ta marrë ose në mënyrë formale vepron, në atë mënyrë me ato mjete në atë kohë dhe vend që të mos arrihet qëllimi i paraparë, i cili qëllim do të arrihej në qoftë se personi zyrtar do të vepronte siç duhet. Pra personi zyrtar nuk bën detyrën e tij për të cilën është i autorizuar dhe duhet ta bëj (këtu vjen në shprehje aspekti material dhe formal i moskryerjes së detyrës) apo detyrën zyrtare e kryen në atë mënyrë që të mos arrihet rezultati i cili duhet të arrihej po që se do të veprohej ashtu siç duhej (këtu është ruajtur vetëm aspekti formal). P.sh. në qoftë se inspektori i policisë, gjatë një zënke private me një qytetar të rëndomtë bën rrahjen e një personi tjetër duke i shkaktuar atij lëndime të rënda trupore, i njëjti nuk do të përgjigjet për vepër penale keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit, por për vepër penale lëndim i rëndë trupor i paraparë në nenin 131 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë. Që kjo vepër të jetë e kompletuar në aspektin formal juridik duhet të plotësohen edhe disa kushte tjera. Pra për të qenë vepra e kompletuar, si rezultat i veprimeve të bëra nga personat zyrtar pa marrë parasysh për cilën formë të saj bëhet fjalë, kusht për të marr trajtën e inkriminimit, është që gjatë veprimeve të tilla kryerësi i veprës të përfitoj për vete ose për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetrit t'i bëj dëm. Dobia ose dëmi mund të jetë në pronë dhe te mira tjera materiale, por mund të shprehen edhe si dobi ose dëm me karakter jomaterial. Paragrafi 1 i keqpërdorimit të pozitës zyrtare që u përmend më lart, është baza e kësaj vepre, dhe në bazë të njëjtit kryerësi i veprës dënohet me burgim prej gjashtë deri në tre vite.

2. Trajtime historike të veprave penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare

Është iluzive, as që është e dëshiruar, të kërkojë krijimin e strukturës shtetërore, paralajmërojnë në Shtetin e Platonit - utopi dhe idealizëm. Megjithatë, transparencja maksimale dhe përpjekje të përbashkët drejtuar individëve për të parandaluar përdorimin e shërbimeve për realizimin e interesit të vet personal, duke mos hezitur në të njëjtën kohë kryerjen e veprave penale, janë sigurisht me rëndësi të veçantë dhe jetike. Ndërgjegjia duhet të drejtohet te e përgjithshmja, në vend të individit. Kuptimi i përgjithshëm i përgjegjësisë në doktrinën e së drejtës ka kuptime të ndryshme. Për shembull, përgjegjësi për pasojën e

⁵Jovashević, D, Zloupotreba službenog položaja i korupcija, Nomos, Beograd, 2005.

shkaktuar me veprimet e veta, përgjegjësi si detyrim për përmbushjen e detyrave të caktuara juridike. Sipas përkufizimeve të dhëna, përgjegjësia, përfaqëson një raport të dyanshëm ndërmjet dy subjekteve. Raport midis atij që përgjigjet dhe atij para të cilit përgjigjet i pari. Vepra penale është kategoria kryesore në sistemin e së drejtës penale. Vepra penale legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe përcakton gjerësinë e represionin penal-juridik, kurse nga nocioni i saj nxirren edhe kategori të tjera themelore, si përgjegjësia penale dhe dënimi⁵. Përgjegjësia penale përcaktohet sipas disa kriterëve shkencore të parashikuar në ligjin material dhe që trajtohen nga doktrina, nga teoria e së drejtës penale. Këto kriteret janë të natyrës juridike dhe faktike. Kriteret juridike kanë të bëjnë kryesisht me disa përcaktime të ligjit, ose të teorisë të së drejtës penale. I tillë është parimi i mosdënimit pa ligj, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose si kundravajtje penale⁶. Kriteret e natyrës faktike kanë të bëjnë me rrethanat e kryerjes së veprës. Prej tyre, të drejtës penale i interesojnë së pari, ato rrethana që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale dhe së dyti, rrethanat, të cilat shërbejnë për të arritur në përfundimin nëse ekziston apo jo ana subjektive e figurës së veprës penale, nëse personi ka vepruar me faj, rast pas rasti. Në teorinë e së drejtës penale janë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e veprës penale. Së pari, vepra penale trajtohet si një fenomen juridik. Por vepra penale konsiderohet edhe si fenomen social. Si veprim apo sjellje e njeriut të caktuar nga e cila dëmtohen apo rrezikohen vlera të caktuara të shoqërisë apo të individit. Në këtë aspekt, kjo sjellje e njeriut, (veprimi apo mosveprimi) e cila është në kundërshtim me interesat e shoqërisë ose të individit, midis të tjerash është një manifestim i personalitetit të tij, është një shprehje e gjëndjes së tij psikike në një moment të caktuar.

Vepra penale konsiderohet si fenomen juridik apo fakt juridik, i cili shkakton pasoja juridike në botën e jashtme. Pra, me veprë penale në aspektin formal do të kuptojmë atë sjellje njerëzore, e cila me ligj është sanksionuar si veprë penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është veprë penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjshme. Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet veprë penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjshme. Në aspektin material, vepra penale është veprë apo sjellje e njeriut, e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Bëhet fjalë

⁶I. Elezi., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009.

për vlera jetike nga të cilat varet ekzistenca e individit dhe e shoqërisë. Do të konsiderohetvepër penale ajo sjellje e njëriut që duhet të paraqesë rrezikshmëri shoqërore. Sipas këtij përkufizimi, kjo sjellje e njëriut, pavarësisht se është e kundërligjeshme, por që nuk është e rrezikshme për shoqërinë, nuk përbën veprë penale. Përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore ligjvënësi e bën në bazë të kushteve objektive të shoqërisë.

Vlerësimi, nëse një veprim apo mosveprim paraqet rrezikshmëri shoqërore, bëhet duke u nisur nga interesat e kësaj shoqërie. Nga këto nocione të veprës penale vihet re se kuptimi formal e shpjegon faktin vetëm në aspektin juridike formal. Kurse, nocioni material, jep përgjigje se për çfarë shkaqesh një veprë konsiderohet veprë penale, arësyet se përse ai veprim është i dëmshëm. Të marra në mënyrë të shkëputur, këto dy teori, nuk e përcaktojnë në mënyrë adekuate dhe në tërësi nocionin e veprës penale. Si konkluzion, mund të thuhet se vepra penale përkufizohet vetëm nëse merren parasysh elementët formal dhe material të saj. Numri më i madh i kodeve penale të shteteve perëndimore si, Kodi Penal Francez, Kodi Penal Gjerman dhe ai Zvicerian, nuk njohin përkufizim ligjor të nocionit të veprës penale. Në legjislacione të tjera janë pranuar dy përkufizime ligjore, ai formal dhe material⁷.

3. Trajtime komparative të veprave penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare

Trajtimi i të dënuarit në IEVP, ka specifika sepse në to ai përfshihet në programe të plota dhe individuale trajtimi, punësimi, argëtimi, kulture, informimi dhe komunikimi, për disa vite (i dënuari me burgim të përjetshëm, do të kalojë gjithë jetën). Ky trajtim i tij, i nënshtrohet një morri problemesh, kushtesh, mundësish, të cilat fillojnë që gjatë trajtimit në fazën fillestare të personave që janë futur në rrugën e krimit. Dihet që, qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja ndaj të dënuarit, por risocializimi dhe ri integrimi i tij në familje dhe në shoqëri. Në këtë kontekst, mbetet aktuale edhe sot thënia e Nelson Mandelës: “Thuhet se askush nuk e njeh me të vërtetë një komb, pa u futur njëherë brenda burgjeve të tij. Një komb nuk duhet të gjykohet nga mënyra si i trajton qytetarët e tij shembullorë, por ata më të këqijtë”. Parë në këtë këndvështrim, analizojmë se si e kemi situatën në trajtimin e personave të akuzuar / viktimë në fillimin e një procedimi penal, deri në momentin e dhënies së një vendimi gjyqësor dhe dërgimin e të akuzuarit në IEVP, për procedura të mëtejshme. Shoqëria udhëhiqet nga parime e norma të cilat në shekuj kanë marrë forma të ndryshme, duke filluar

⁷I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë, Tetor 2010.

nga kanunet, ligjet, kodet, deri tek kushtetutat, të cilat kanë pasqyruar në një formë ose një tjetër vullnetin e shoqërisë (vullnetin e çdo njeriu, i cili nuk mund të shkojë kundër vullnetit të shumicës). Këto norma, janë për të rregulluar sa më mirë atë pjesëz të jetës shoqërore, jetën tonë, që është pjesa më e rëndësishme dhe që na intereson mbi çdo gjë⁸.

Interesimi për krimin dhe autorin nga shoqëria ka qenë shumë i hershëm, duke e trajtuar gjerësisht në teori, nxjerrë ligje etj., ndërsa interesimi dhe trajtimi i viktimës së krimit është relativisht i ri. Nga ana tjetër, paraqitet nevojë e kohës studimi, hulumtimi dhe kërkimi shkencor në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me viktimën e krimit, në veçanti me pozitën e saj në sistemin e drejtësisë penale. Në mjaft vende të avancuara sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut, ka një orientim serioz e qasje praktike për trajtim dinjitoz të personave që e kanë pësuar nga krimi.

Prandaj edhe janë nxjerrë konventa, ligje, rregullore etj., për të garantuar mbrojtje në aspektin juridik, si dhe janë ngritur institucione të posaçme me qëllim sigurimin e një sistemi sa më të fuqishëm të drejtësisë për mbrojtjen e pozitës së viktimës së krimit. Në vendin tonë, megjithëse ka një përparim sa i përket të drejtave të viktimës së krimit, konstatohet se ende nuk ka barazi në raport me autorin në rrafshin e trajtimit juridik të pozicioneve të tyre si subjekte të aktit kriminal. Trajtimi i viktimave të krimit nga Policia e Shtetit dhe marrja në pyetje e tyre, shpesh nxjerr në pah probleme të mëdha dhe shqetësuese. Pas kryerjes së veprës penale, kontakti i parë i viktimës me sistemin e drejtësisë bëhet zakonisht përmes Policisë së Shtetit. Ky kontakt mund të vazhdojë edhe gjatë hetimeve paraprake, deri në fillimin e procesit gjyqësor, por prej tij varet shumë rrjedha e procedurës jo vetëm me mbrojtjen e viktimave dhe kompensimin e tyre, por edhe me një punë më efektive për parandalimin e krimit dhe viktimizimit në shoqëri.

Bashkëveprimi i parë ndërmjet policisë dhe viktimës është thelbësor edhe në lidhje me atë se si viktima do ta përballojë viktimizimin dhe do të rimarrë veten. Në këtë drejtim është me rëndësi që ndihma e parë dhe mbrojtja e personave në nevojë, fillimisht të ofrohet dhe të koordinohet nga organet shtetërore, ku roli i policisë dhe i medieve, është me shumë rëndësi.

Kjo situatë paradoksale, vjen si rezultat i gamës së kompetencave dhe fuqive ligjore që gëzojnë punonjësit e institucioneve të zbatimit të ligjit, në mënyrë që të jenë në gjendje të

⁸Elezi I. "Mbi Kriminologjinë", Tiranë 2005.

zbatojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Por duhet të jetë e qartë, se qëllimi i pushtetit ligjvënës të shtetit nuk është përdorimi i paligjshëm apo arbitrar i kompetencave dhe fuqive. Shpërdorimi apo keqpërdorimi i tyre, si arrestimi apo ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, falsifikimi i provave, përdorimi i tepruar i forcës apo i armëve, keqtrajtimi i të ndaluarve dhe tortura, kontrolli i paligjshëm i banesës, janë disa nga shembujt e shumtë të ditëve të sotme të praktikave të paligjshme dhe të papranueshme të punonjësve të zbatimit të ligjit⁹, të cilat shpesh ndodhin jo vetëm në Republikën e Maqedonisë, por dhe në vende të tjera të botës. Në këtë realitet të shoqërisë shqiptare, më këtë kriminalitet të përgjithshëm, të miturve, të femrave, të meshkujve, secili prej nesh - në një mënyrë apo tjetër - mund të bëhet objekt (viktimë) apo të ndjehet i lidhur me veprime kriminale të llojeve të ndryshme, “të vogla” apo edhe të tilla si tortura, trajtime a dënime jo-njerëzore e poshtëruese. Ndikimi i këtyre veprimeve është real edhe pse mund të mos jemi ne ata që i kryejmë apo vuajmë direkt pasojat e tyre. Format kualifikuese të kësaj vepre janë të parapara në paragrafin 2, 3, 4 dhe 5 të cilat vijnë në shprehje në varësi të përfitimit apo dëmit si dhe statusit të personit në cilësinë e kryerësit të veprës.

Për shembull : në qoftë se kryerësi i veprës do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë apo do të shkaktojë dëm më të madh të pasurisë të tjetërkujt, vjen në shprehje paragrafi i dytë. Kurse në qoftë se kryerësi i veprës përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, atëherë vjen në shprehje paragrafi i tretë i kësaj vepre. Paragrafi i katërt i shtohet kësaj vepre me vonë, si rezultat i asaj se shumë veprime kriminale gjatë periudhës së tranzicionit posaçërisht gjatë privatizimit të ndërmarrjeve mbetën pa u sanksionuar, meqë në atë kohë nuk ishte paraparë përgjegjësi penale për personat përgjegjës në personin juridik. Pikërisht mu për këtë kjo mangësi u tejkalua në vitin 1999 ku kjo vepër penale u pasurua edhe me paragrafin katërt, ku si shkelës i kësaj forme ligjore sanksionohet edhe personi përgjegjës në personin juridik qoftë ai i huaj apo vendor⁹.

Paragrafi i pesë paraqet formën më të rëndë të kësaj vepre, i cili është paraparë me ndryshimin e kodit penal të bërë në vitin 2004, dhe i njëjti sanksionon të gjitha ato keqpërdorime që kanë të bëjnë gjatë kryerjes së furnizimeve publike ku dëmtohet buxheti shtetëror. Po qe se bëhet një shkelje e tillë kryerësi i veprës do të dënohet më së paku me pesë

⁹Pikërisht mu për këtë kjo mangësi u tejkalua në vitin 1999 ku kjo vepër penale u pasurua edhe me paragrafin katërt, ku si shkelës i kësaj forme ligjore sanksionohet edhe personi përgjegjës në personin juridik qoftë ai i huaj apo vendor.

vjet burgim. Shembulli i mëparshëm tregon qartë për veprën penale kundër detyrës zyrtare, ku personi zyrtar ka injoruar kërkesat ligjore dhe detyrimin për të vepruar mbi ta. Për fat të keq, kjo praktikë është shumë e njohur për ne. Për këtë arsye, ne duhet të kuptojmë se ky rast i vetëm, të cilin e ndjekin dhe shumë të tjerë njëjtë ose ngjashme, është pengim drejtuar drejt të gjithë ne, në kuptimin që detyra zyrtare pa integritet, jofunksional, nën vallon e veprave penale – frenim i interes të përgjithshëm.

3.1 Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë

Shpërdorimi i detyrës zyrtare, neni 248

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.

Përfitimi i paligjshëm i interesave - neni 257.

Mbajtja, ruajtja ose marrja e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë, nga persona me funksione shtetërore apo shërbim publik, i një interesi të çfarëdoshëm në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikqyrjes, administrimit ose likuidimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet¹⁰.

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike – neni 244. (Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 18; pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 48) Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtëpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet¹¹.

¹⁰Ligji për ndryshim dhe plotësim i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, 2004 dhe 2007.

¹¹Ligji për ndryshim dhe plotësim i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, 2004 dhe 2013.

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë – neni 245. (Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 19; pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 48) Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet¹².

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike – neni 259 (Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 22).

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë.

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë sanksionon dy lloje dënimesh, dënimet kryesore dhe ato plotësuese. Dënimet kryesore janë të parashikuara në nenin 29 të KP-së. Në llojin e dënimeve kryesore, të cilat mund të jepen nga gjykatat e zakonshme më vete, për personat që kanë kryer krime, hyjnë dënimin me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim dhe ai me gjobë. Ndërsa për personat që kanë kryer kundërvajtje dënimet kryesore janë dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë. Dënimin me burgim parashikohet nga neni 32 i KP-së, ndërsa dënimin me gjobë nga neni 34 i KP-së. Përveç dënimeve kryesore, gjykatat kur e çmojnë të arsyeshme, bashkë me dënimin kryesor mund të caktojnë edhe një ose më shumë dënime plotësuese, të parashikuara nga neni 30 i KP-së, në lidhje dhe me nenet 35-43 të tij.

¹²Po aty.

3.2 Krahasim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – për dallim nga neni 353 Kapitulli XXX të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre (3) vjet, me atë që personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, për dallim nga neni 353 Kapitulli XXX të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre (3) vjet.

Korrupsioni zyrtarë dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare janë një fenomen i cili daton prej kohërave të hershme mirëpo i cili në ditët e sotme ka arritur kulmin e ekspansionit të tij, një fenomen i cili është aq i dëmshëm dhe sfidues për shtetet dhe stabilitetin e tyre ekonomike dhe financiar, duhet të luftohet dhe me të gjitha masat që shtetet kanë në dispozicion. Republika e Kosovës me një administratë publike dhe një shoqëri kryesisht të re e cila premtion një potencial të jashtëzakonshëm në zhvillimin e vendit i nevojitet përvojë pune dhe profesionalizëm në zhvillimin e shtetit ligjorë duke parandaluar dhe luftuar e fenomenit të korrupsionit zyrtar¹³. Korrupsioni zyrtar si fenomen shoqërorë përfshin të gjitha veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat veprime i merr personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës dhe autoritetit zyrtar, zyrtari cili ka autorizim dhe kompetencë në ushtrimin e funksioneve zyrtare brenda një institucioni publik ose privat është i obliguar që sjelljet e tij të harmonizojë me rregullat dhe normat të cilat ligji ose aktet nënligjore i parashohin. Pothuajse të gjitha shtetet, madje dhe shoqëritë bashkëkohore me traditë legjislative kanë probleme me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, personat zyrtar të cilët kanë autoritet dhe kompetenca për të ushtruar në administratën publike, duke e përdorur autoritetin e tyre ligjor e shpërfillin ose keqpërdorin autoritetin për të i sjellë të mira vetës ose personit tjetër në mënyrë të kundërligjshme. Pjesa më e madhe e shtetet demokratike kanë nxjerr legjislacionin kundër veprave të tilla penale, madje shumë shtete krijojnë edhe mekanizma shtesë institucional për të parandaluar, luftuar dhe ndjekur kryesit e këtyre veprave penale.

Në Kosovë, deri tani rastet e ndjekjeve penale të aferave korruptive të zyrtarëve të lartë janë

¹³Veprat penale kundër korrupsionit sipas Kodit të Ri Penal të Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV

ndjekur, në mënyrë të pjesshme, nga Prokuroria e Misionit të EULEX-it¹³. Ndërkohë, Prokuroria e Kosovës është marrë kryesisht me raste të korrupsionit të vogël. Duke i njohur rëndësinë e merituar nevojës për të luftuar korrupsionin e vogël, është i domosdoshëm adresimi me intensitetin dhe seriozitetin e merituar i korrupsionit të madh, veçanërisht për dëmin financiar dhe social shumë-fish më të madh që shkakton. Problemi qëndron në nevojën për të hetuar “koka të mëdha”.

Në rastin konkret, me të dëgjuar regjistrimet në fjalë, lehtësia me të cilën diskutohen intervenimet në institucione të pavarura të bën të mendosh që këta “shefa” të Kosovës meritojnë medaljen e artë në Olimpiadën e korrupsionit. Si rrjedhojë, ata gjithashtu meritojnë që çdo informacion i referuar të hetohet në detaj, për të kuptuar nëse është e merituar apo jo kjo medalje.

Republika e Kosovës me një administratë publike dhe një shoqëri kryesisht të re e cila premtton një potencial të jashtëzakonshëm në zhvillimin e vendit i nevojitet përvojë pune dhe profesionalizëm në zhvillimin e shtetit ligjorë duke parandaluar dhe luftuar e fenomenit të korrupsionit zyrtar¹⁴.

Korrupsioni zyrtar si fenomen shoqërorë përfshin të gjitha veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat veprime i merr personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës dhe autoritetit zyrtar, zyrtari cili ka autorizim dhe kompetencë në ushtrimin e funksioneve zyrtare brenda një institucioni publik ose privat është i obliguar që sjelljet e tij të harmonizojë me rregullat dhe normat të cilat ligji ose aktet nënligjore i parashohin. Pothuajse të gjitha shtetet, madje dhe shoqëritë bashkëkohore me traditë legjislativë kanë probleme me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, personat zyrtar të cilët kanë autoritet dhe kompetenca për të ushtruar në administratën publike, duke e përdorur autoritetin e tyre ligjor e shpërfillin ose keqpërdorin autoritetin për të i sjellë të mira vetës ose personit tjetër në mënyrë të kundërligjshme. Pothuajse të gjitha shtetet, madje dhe shoqëritë bashkëkohore me traditë legjislativë kanë probleme me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, personat zyrtar të cilët kanë autoritet dhe kompetenca për të ushtruar në administratën publike, duke e përdorur autoritetin e tyre ligjor e shpërfillin ose keqpërdorin autoritetin për

¹⁴Ligji për ndryshim dhe plotësim sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV

të i sjellë të mira vetës ose personit tjetër në mënyrë të kundërligjshme. Pothuajse të gjitha shtetet, madje dhe shoqëritë bashkëkohore me traditë legislative kanë probleme me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, personat zyrtar të cilët kanë autoritet dhe kompetenca për të ushtruar në administratën publike, duke e përdorur autoritetin e tyre ligjor e shpërfillin ose keqpërdorin autoritetin për të i sjellë të mira vetës ose personit tjetër në mënyrë të kundërligjshme. Pjesa më e madhe e shtetet demokratike kanë nxjerr legjislacionin kundër veprave të tilla penale, madje shumë shtete krijojnë edhe mekanizma shtesë institucional për të parandaluar, luftuar dhe ndjekur kryesit e këtyre veprave penale. Edhe organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare kanë nxjerr konventa të veçanta kundër dukurisë së korrupsionit, organizata e Kombeve të Bashkuara (tutje OKB) ka nxjerr konventën kundër korrupsionit si dhe Këshilli i Evropës (tutje KE) ka nxjerr konventën penale kundër korrupsionit, ndërsa pjesa më e madhe e shteteve pjesë e këtyre fenomeneve¹⁵.

Krahasimi qëndron në atë që Republika e Kosovës ka një administratë të re publike, derisa tani rastet e ndjekjeve penale të aferave korruptive të zyrtarëve të lartë janë ndjekur, në mënyrë të pjesshme, nga Prokuroria e Misionit të EULEX-it.

Eksperiencia botërore në kriminologji konfirmon që ballafaqimi i zyrtarëve të lartë me turpërim publik, arrestim, subjektivizim si subjekt i ndjekur penalisht dhe dënim të merituar, thellon kulturën e ndëshkueshmërisë dhe frenon rastet e korrupsionit në të ardhmen.

(Autorja është candidate për Ph.D. në të Drejtën Ndërkombëtare në IHEID, Gjenevë. Ka mbaruar studimet M.Sc. në Kriminologji dhe Drejtësi Penale në Universitetin e Oxfordit. Ka punuar për USAID, zyrën Anti-Korrupsion KEK – Kosovë, si dhe në Zyrën e Prokurorit në Tribunalin e Hagës për Krimet në ish-Jugosllavi. Interesat e saj kërkimore janë mbi garancitë për mos përsëritje të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut) - Nita Shala – Misioni, pandëshkueshmëria dhe nevoja e një Misioni Ndërkombëtar.

¹⁵Organizata e Kombeve të Bashkuara (tutje OKB) ka nxjerr konventën kundër korrupsionit si dhe Këshilli i Evropës (tutje KE) ka nxjerr konventën penale kundër korrupsionit.

3.3 – Krahasim me Kodin Penal të Bosnjës Hercegovinës

Veprat penale kundër detyrës zyrtare paraqesin akte të paligjshme të dedikuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike që kryejnë personat zyrtarë ose të autorizuar që veprojnë në cilësi të personit zyrtar apo në lidhje me ushtrimin e saj. Këto loja të veprave penale sot bie në kategorinë e kriminalitetit me një shkallë jashtëzakonisht të lartë të rreziqeve për shoqërinë. Kjo pasqyrohet jo vetëm në pasojat materiale të ushtrimit të këtyre akteve, por sidomos në shkatërrimin dhe ndërprerjen e tendencave themelore të jetës shoqërore përmes një goditje ndaj vlerave morale shoqërore¹⁶.

Shikuar në mënyrë arkeologjike, kjo sigurisht nuk është një virtut që duhet ta posedojë një zyrtar në aktivitetet e tij. Përveç pasojave të dukshme të shkeljes së ligjit penal, veprimet e drejtuara kundër detyrës zyrtare dëmtojnë autoritetin dhe integritetin e qeverisë. Kryerësit kryesisht janë të emëruar si persona zyrtar (*delicta propria*). Autorët e këtyre veprave penale janë zyrtarë dhe shpesh kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare¹⁷.

Vetë fakti që autorët janë persona zyrtarë, përveç kryerjes së vetë veprës, tregojnë një rrezik tjetër. Fjala është për përpjekje për të fshehur veprat duke ripërdorur pozitën. Një rrethanë tjetër rënduese është i gjithë rrjeti i personave të involvuar. Në këtë mënyrë është e vështirë që prokuroria dhe organet e tjera hetimore të depërtojnë në një tërësi të tillë kohezive, e cilat në mënyrë kolektive pasqyrojnë shtyllën kurrizore të paligjshmërisë.

Ad absurdum është, që në fakt, e tërë ajo që përpiqet të thyejë, është ose duhet të jetë, realizimi i funksionalitetit të rregullave kushtetuese dhe ligjore nëpërmjet punës dhe organizimit të duhur. Kryerja e një vepre penale kundër detyrës zyrtare nuk është vetëm mënyra e realizimit të thelbit ligjor të veprës dhe të përdhosjes së shërbimit. Aktet e ndryshme, të cilat janë grupuar me emrat e grupeve të këtyre akteve kundër detyrës zyrtare, gjithashtu shkaktojnë shumë pasoja të tjera të paligjshme ndaj palëve të treta.

Pas këtyre etiketimeve të grupeve të përgjithshme ndodhen vepra penale që cenojnë ose rrezikojnë vlera të ndryshme si të drejtat e njeriut, pronat e tij dhe të ngjashme.

¹⁶Grup autorësh, nga Kodi Penal në Bosnje dhe Hercegovinë, Këshilli dhe Komisioni Evropian, Sarajevë, 2005.

¹⁷E drejta penale, pjesa e posaçme, Magistrat, Sarajevë, 2003.

Pas këtyre etiketimeve të grupeve të përgjithshme ndodhen vepra penale që cenojnë ose rrezikojnë vlera të ndryshme si të drejtat e njeriut, pronat e tij dhe të ngjashme.

Megjithatë, këtu është shërbimi parësor i mbrojtjes, zbatimi i të cilit është ligjrisht jetik për funksionimin e të gjithë komunitetit. Është e rëndësishme të theksohet se ky lloj i akteve ndaluese, konceptuale, përfshin jo vetëm organet e administratës shtetërore, por edhe të gjitha shërbimet me autoritetet publike¹⁷ (arsim, shëndetësi, sistemi bankarë, etj). Në mënyrë plotësuese më tej diskuton rëndësinë e shërbimit ndaj autoriteteve publike, si me konsensus Omnium në tërë shoqërinë, si dhe për funksionimin e duhur dhe efikas të sistemit ligjor dhe social.

Në Kodin Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës (në tekstin e mëtejshëm: K.P. i B dhe H) personi zyrtarë është përcaktuar si "të zgjedhur ose të emëruar zyrtar në organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe institucionet apo shërbime të tjera qeveritare dhe administrative të cilat kryejnë punë administrative, profesionale ose detyra të tjera në suaza të drejtave dhe detyrave të autoriteteve që i kanë themeluar; një person i cili rregullisht ose herë pas here kryen detyra zyrtare në organet ose institucionet administrative në fjalë; personi i autorizuar në një ndërmarrje biznesi ose subjekti tjetër juridik, që në bazë të ligjit ose rregulloreve të tjera të miratuara kryejnë autorizime publike, dhe se në bazë të këtyre autorizimeve kryejnë detyra të caktuara; dhe çdo person tjetër i cili kryen një funksion të veçantë zyrtarë në bazë të autorizimit ligjor ose rregulloreve të tjera në bazë të ligjit¹⁸".

Në këtë kuptim, këto vepra penale nuk janë vetëm "zyrtare", çka që në mënyrë implikuese përfshinë persona të tjerë si kryerës të njëjtave (p.sh. tek mitë-dhënia). Me pozitën e tyre, në bazë të arsimimit dhe profesionalizmave të tyre, kryerësit e këtyre veprave dallojnë shumë nga kryerësit e veprave penale nga fushat e tjera të krimit. Veprimet e tyre, duke pasur parasysh rolin e tyre në shërbim, si dhe të gjitha format e kriminalitetit më serioz, siç thekson prof. Baçiq "godet sigurinë e vendit në marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme¹⁹." Si të tilla, ata vërtetë duhet edhe të kuptohen. Pasojat e keqpërdorimit të përgjegjësive të funksioneve destabilizojnë simbiozën e tërësisë administrative dhe krijojnë një atmosferë të pasigurtë, që rezulton nga një mosbesim i madh i qytetarëve në organet përgjegjëse për sigurinë e tyre.

¹⁸E drejta penale, pjesa e posaçme, Banja Llukë, 2007.

¹⁹Kodi Penal Bosnjë dhe Hercegovinë, Pjesa e përgjithshme, 2003.

Prandaj, në ekzekutimin e këtyre veprave penale, si formë pengese, parashihet vetëm qëllimi. Prandaj, personat zyrtarë gjithmonë veprën e kryejnë me një akt intuitë dhe kjo është më së shpeshti në lidhje me qëllimin e drejtpërdrejtë²⁰ (*dolus directus*).

Një element i ndërgjegjesimit joligjor është veçanërisht i theksuar në funksionin që e ushtron ky person. Për dallim nga kjo, paligjshmëria përcaktohet si një element i veçantë i qenies së ligjshme në këto akte. Po kështu, shërbimet publike, të cilat merren me të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, përkatësisht zyrtarët në atë punë, në veçanti janë të ekspozuar ndaj kësaj forme të krimit. Marrja e vendimeve për ndërtimin, doganimin e mallrave, dhënien e lejeve dhe vendimeve të tjera të lejueshme janë në veçanti të ekspozuar nga presionit i korrupsionit. Kështu, në zgjidhjen e këtyre çështjeve, personat zyrtarët vendim marrjet i formësojnë sipas vullnetit të personave të tjerë. Si shpërblim për këtë, këta njerëz fitojnë fitim të paligjshëm. Në këtë mënyrë, përveç funksionimit legjitim të autoriteteve kompetente, ato dëmtojnë drejtpërdrejt buxhetet e komuniteteve territoriale-politike, të drejtat e të tjerëve dhe një tërësi të aparatit shtetëror. Ky aparat, duke reduktuar punën progresive-operacionale, pasqyron pasojat negative në të gjithë popullsinë. Me pak fjalë, shumë vepra penale të kësaj forme së bashku krijojnë një fenomen global negativ të korrupsionit. Përveç personit zyrtar, si kryerësi dominohet dhe personi përgjegjës; persona të tjerë përveç atyre primarë, që në suaza të autorizimeve të tyre mund të kryejnë këto vepra penale. Personi përgjegjës është personi që i është besuar një fushë e caktuar afarizmi në fushën e biznesit ose personave të tjerë juridik. Krahasimi qëndron në atë që keqpërdorimi i detyrës zyrtare sipas nenit 220, personi zyrtar ose përgjegjës në institucionet e Bosnjës dhe Hercegovinës, që me keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar, tejkalon kufijtë e autoritetit zyrtar ose nuk përmbush detyrën zyrtare, të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, do të dënohet me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite, po ashtu për marrje të ryshfetit dënohet me burg.

²⁰Paraqitja e punëve të paligjshme që u është besuar detyrimeve të caktuara zyrtare nuk është paraqitje e kaluar. Ajo është paraqitje që paraqitet dhe në kushte bashkëkohore, në të gjitha shtetet pa marrë parasysh rregullimin shoqëror-ekonomik të tyre dhe sistemin politik. Beteja kundër kësaj paraqitje dhe sot është aktuale, pasi praktika tregon se përveç ndërmarrjes të gjitha masave të kujdesit, nuk janë të gjithë personat e aftë dhe të përgatitur ta kryejnë atë detyrim që u është besuar për ta kryer që atë detyrim ta kryejnë ligjërisht dhe në përputhje me nevojat shoqërore. Prandaj sot mjaft vende, në përputhje me nevojat e tyre, ndërtojnë sistem masash për ndërprerjen e shkeljeve në detyrën zyrtare dhe në suaza të atyre masave përcaktojnë për cilat shkelje këto detyrimen vijnë deri në zbatimin e sanksioneve penale.

3.4 – Krahasim me Kodin Penal të Kroacisë

Kryerësi i kësaj vepre mund të jetë çdo person zyrtar. Veprat penale të veçanta mund të kryhen vetëm në ushtrimin e një shërbimi të caktuar²¹. Kryerësi mund të jetë vetëm një person zyrtar i caktuar. Është e rëndësishme të theksohet se ekziston një dallim i qartë në mes të veprave penale që materializohet me shkeljet e legjislacionit në ushtrimin e detyrave zyrtare të shkeljeve të tjera, të cilat nuk janë përcaktuar me ligj si vepra penale. Me fjalë të tjera, këta të tjerë janë më pak të rrezikshëm dhe rrjedhimisht sanksionohen me procedura disiplinore. Megjithatë, nuk janë të gjitha shkeljet e tilla vepra penale, por vetëm shkeljet më serioze, ndërsa një numër i shkeljeve të vogla të detyrave zyrtare përbëjnë shkelje disiplinore¹⁸. Dallimet e tyre, përveç përmbajtjes, reflektohen edhe në intensitetin dhe shtrirjen e pasojave. Vepra penale kundër detyrës zyrtare (d.m.th. një nga format e saj, e cila do të paraqiten në kreun tjetër) ka një pasojë më të thella dhe më të gjera, në krahasim me shkeljet e vogla, që rezultojnë me reperkusion jo aq të madh ndaj shoqërisë në përgjithësi¹⁹. Në pjesën e mëparshme kemi përmendur tashmë korrupsionin si një faktor thelbësor në konceptin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, përveç aktit vullnetar të një zyrtari që me kryerjen e kësaj vepre, injorojnë jo vetëm kodeksin e profesionit të tyre por dhe më e rëndësishmja - vetë ligjin. Në të vërtetë korrupsioni është "plagë", e cila gjithmonë e shoqëron njerëzimin - sfidën, presionin, tundim i madh, i cili përmes materiale formëson dëshirën; godet pothuajse në të gjitha poret e jetës, duke lënë pas mjaft të dëmtuar dhe të pambrojtur, mbrojtja dhe shpresa e të cilëve është shtet funksional ligjor. Korrupsioni në rrjedhën e zhvillimit historik është gjithnjë e më tepër ka depërtuar nëpër labirintet e aparateve të fuqishme shtetërore dhe ka vepruar si opium në strukturat e nëpunësve shtetëror²¹.

Struktura dhe rëndësia e veprave të inkriminuara kundër detyrës zyrtare nuk mund të shpjegohen plotësisht pa një kuptim empirik të nocionit korrupsion. Mekanizmi mbrojtjes i personave zyrtarëve (që do të zvogëlojë në mënyrë statistikore kryerjen e veprave penale kundër detyrës zyrtare), që dhe vetë shtetet, duhet të dalin nga strategjitë e zhvilluara në luftën kundër korrupsionit, si dhe në ngritjen e punës së personit zyrtar në nivel më të lart etik dhe profesional.

Sfida e parë në krijimin e një strategjie kundër korrupsionit është besimi tek ata që e propozojnë dhe e zbatojnë atë. Besimi (*trust*) është legjitimimi i veprimit dhe themeli për një

²¹Veprat penale kundër detyrës zyrtare, Zagreb, 2009.

udhëheqje të besueshme efektive (*credible leadership*). Një program serioz anti-korrupsion nuk mund të imponohet nga jashtë pa dorëzim udhëheqës nga brenda, në mënyrë ideale nga përfaqësuesit e ligjshëm në nivelin më të lartë²². Tabela në vijim është një nga anketimet e kryera në mesin e banorëve të rajonit (dhe vendeve të tjera) për sa dhe si ndikon korrupsioni në vendet e tyre :

Për fat të keq, kjo praktikë është shumë e njohur për ne. Për këtë arsye, ne duhet të kuptojmë se ky rast i vetëm, të cilin e ndjekin dhe shumë të tjerë njëjtë ose ngjashme, është pengim drejtuar drejt të gjithë ne, në kuptimin që detyra zyrtare pa integritet, jofunksional, nën vallon e veprave penale – frenim i interes të përgjithshëm.

Krahasimi qëndron në atë që keqpërdorimi i detyrës zyrtare sipas nenit 291, personi zyrtar ose përgjegjës që keqpërdor pozitën dhe autoritetin zyrtar, tejkalon kufijtë e autoritetit zyrtar ose nuk përmbush detyrën zyrtare, të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, do të dënohet me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite, kurse kryerësi dënohet me dënim me burg prej një deri dymbëdhjetë vite, po ashtu për marrje të rryshfetit dënohet me burg.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kroacisë, kemi dallim të vlera e fitimit pasuror që nëse tejkalon pesëqind e pesëdhjetë mijë dinarë kroat, dënohet me burgim prej dhjetë vjet, që dallon nga Kodi Penal në Republikën e Maqedonisë që për tejkallim të dobisë së konsiderueshme dënohet me tre vjet burg dhe nëse vlera e pasurisë tejkalon dy milion dinarë kroatë, kryesi dënohet me burgim për të paktën tre vjet, pra Kodi Penal i Kroacisë është më rigoroz. Kurse sipas pikës 1, nëse personi zyrtar shkakton dëme të përdorë pozitën dhe autoritetin e tij, dënohet me burgim deri 3 vjet, sipas pikës 2, nëse vepra e përmendur rezulton me dëme të konsiderueshme të drejtave të tjetrit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

²²Vendi dhe perspektivat e shkencave kriminalistike dhe profesionet kriminalistike në kushtet bashkëkohore, Sarajevë, mars 2001.

3.5 – Krahasim me Kodin Penal të Serbisë

Risi në legjislacionin penal të Republikës së Serbisë – vepër penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtarë” dhe vepër penale “Keqpërdorimin i pozitës të personit zyrtarë”.

Spektori publik - është i një rëndësie të veçantë, para së gjithash, sepse përbëhet nga subjekte të veçanta që, në kryerjen e veprimtarisë së tyre, kanë përgjegjësi si për publikun ashtu edhe për themeluesin. Përgjegjësia e tij në veçanti është reflektuar edhe në detyrimin për të informuar publikun për aktivitetet dhe operacionet e saj, si në rastin e operacioneve të papërshtatshme të sektorit publik, edhe pse shpesh vetëm një nga veprat e tij, janë pothuajse rregullisht të ndjekura nga një pakënaqësi të theksuar të qytetarëve. Spektori publik përfshin forma të ndryshme të organizimit të subjekteve ekonomike individuale nëpërmjet të cilave shteti ose organet e tij lokale sigurojnë realizimin e interesave të caktuara në fusha të caktuara të biznesit. Nën sistemi i parë është buxheti i shtetit ose sektori qeveritar. Koordinimi burokratik është në këtë rol përcaktues. Specialiteti i përbashkët i organeve të ndryshme të buxhetit të shtetit është se promovimi i tyre zhvillohet në një sistem të veçantë të rregullave (që i jep kuadrit të ligjit të përgjithshëm) dhe me kontroll politik të menjëhershëm. Nën sistemi i dytë përbëhet nga ndërmarrjet (shoqatat ekonomike) në pronësi të shtetit ose vetëqeverisjes. Së treti, një nënsistem relativisht i ri është një nënsistem i organizatave jofitimprurëse ose OJQ-ve.

Ky sektor përfshin fondacione të ndryshme private dhe publike, organizata bamirëse, institucione fetare. Një pasqyrë e specifikave më themelore të subjekteve që veprojnë në sektorin publik. Ndërmjet entiteteve që ekzistojnë brenda sektorit publik ka dallime të shumta në vende të ndryshme, aktivitete dhe degë të ndryshme brenda vendeve individuale, si dhe në periudha të ndryshme kohore. E gjithë kjo reflekton në llojet dhe format institucionale të subjekteve, aktivitetin e tyre, statusin që ata kanë në sistemin ekonomik, instrumentet që rregullojnë funksionimin e tyre, si dhe efikasitetin e tyre ekonomik. E gjithë kjo siguron një sasi të konsiderueshme abuzimi, por meqenëse sektori publik ofron mbështetje logjistike për biznesin e subjekteve të tjera të biznesit, ekzistenca e saj nuk është aspak e diskutueshme²⁴. Megjithatë, për këtë sektor, në fushën e informacionit të biznesit, ka disa karakteristika specifike.

Specialiteti i parë lidhet me faktin se publiku është shfrytëzuesi më i madh dhe më i rëndësishëm i këtij informacioni, që do të thotë se sektori publik duhet të ketë një shkallë më

të madhe përgjegjësie për informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare. Një veçori tjetër specifike është se sektori publik duhet të paraqesë informacionin në pasqyrat financiare për publikun në një mënyrë të përshtatshme dhe me kohë, me qëllim të krijimit të klimës pozitive në publik, që në këtë rast, përveç themeluesit, duhet të merret edhe vendimi për të marrë disa zgjidhje jopopullore.

Specifika e fundit i referohet faktit që disa subjekte të sektorit publik duhet të sigurojnë të dhëna për realizimin e planit të mbrojtjes së mjedisit. Publiku është i interesuar të zbulojë nëse disa nga aktivitetet janë të rrezikuara nga mjedisi, kështu që nëse bëhet fjalë për të shmangur ose zbutur efektet negative. Skemat e pavërteta dhe joobjektive të gjendjes financiare dhe rezultatet kryerësit e sektorin publik i realizojnë është pasojë e pavërtetësisë dhe joobjektivitetit në bilanci e subjekteve të veçanta, e cila është një problem për të gjithë ata që kanë shprehur dhe interesat e përcaktuar në sektorin publik. Për këto arsye, përgjegjësia e veçantë qëndron tek auditimi i pavarur dhe profesional i raporteve të kontabilitetit financiar të subjekteve të sektorit publik që nuk mund të menaxhohen në mënyrë të kënaqshme nga një njësi e veçantë dhe si pasojë edhe nga sektori publik. Përveç kësaj, problemi vazhdon ende në lidhje me efikasitetin e biznesit të sektorit publik.

Në mënyrë të veçantë, fokusi i interesit është që të ofrojë shërbime cilësore me kosto minimale. Qëllimi është "i kënaqur ofruesi i shërbimit të sektorit publik, dmth qytetari".

Për të arritur këtë, duhet të futet edhe një model tregu i biznesit në sektorin publik. Pra, koncepti mbi të cilin mbështetet ky sektor është diametralisht në kundërshtim me konceptin e sektorit publik. Megjithatë, sektori publik është një element thelbësor në legjislacionin penal të Republikës së Serbisë, sepse sektori i privat siguron mbështetje logjistike, pa të cilat ekzistenca e saj, megjithatë dhe funksionimi u sollën në pikëpyetje. Nga ana tjetër, sektori privat ka një ndikim të kthyeshëm në sektorin publik. Për të arritur këtë, duhet të futet edhe një model tregu i biznesit në sektorin publik. Pra, koncepti mbi të cilin mbështetet ky sektor është diametralisht në kundërshtim me konceptin e sektorit publik.

Megjithatë, sektori publik është një element thelbësor në legjislacionin penal të Republikës së Serbisë²³, sepse sektori i privat siguron mbështetje logjistike, pa të cilat ekzistenca e saj, megjithatë dhe funksionimi u sollën në pikëpyetje. Nga ana tjetër, sektori privat ka një

²³Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal në RS.

ndikim të kthyeshëm në sektorin publik. Rrjedhimisht, është e qartë se abuzimi i çdo lloji dhe në veçanti ai i kualifikuar si vepër penale në cilëndo prej këtyre sektorëve, mund të ketë pasoja të shumta negative për rezultatin.

Vepra penale "Shpërdorimi i detyrës" ndryshimi i parafundit i Kodit Penal nën 359, i Kodit Penal të Republikës së Serbisë ekskluzivisht rregullon sjelljen në lidhje me abuzimin e detyrës nga ana e personit përgjegjës. Kur është fjala për personin përgjegjës, ligjvënësi paraqet një dispozitë të re kriminale që quhet abuzimi i pozitës së personit përgjegjës (neni 234, KP të RS). Në këtë mënyrë, ligjvënësi në dispozitën e nenit 112, paragrafi 5 specifikon afatin e personit përgjegjës, duke përmendur të gjithë atë që te personi juridik llogarisin personin përgjegjës²⁴. Në këtë mënyrë kemi fituar dy vepra penale, që në thelb, është e pranueshme për shkak se nga njëra anë shpërdorimi i pozitës zyrtare pra sjelljes së drejtuar kundër detyrës zyrtare si një grup i objekteve të mbrojtjes joligjore të kreut të veçantë, ndërsa nga ana tjetër keqpërdorimi i pozitës së personit përgjegjës i përket një grupi të veçantë të veprave penale, i cili ka një sistem biznesi për ndërtimin e sigurisë. Parashikon që një vepër penale të shpërdorimit të detyrës e kryen personi zyrtar me keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të pushteteve, i kalon kufijtë e autoritetit të tij zyrtarë ose duke dështuar në kryerjen e detyrave të tij për veti ose për në një tjetër siguron një përfitim ose shkakton dëm apo shkelje të rëndë të drejtave të tjetrit. Kjo është një vepër penale e përgjithshme dhe themelore penale. Objekt mbrojtës është detyra zyrtare ose ushtrimi e saj të domosdoshëm dhe ligjor, ku e rëndësishme është një shërbim publik ose detyrë në administratën shtetërore, në një kuptim më të gjerë. Është theksuar se detyra zyrtare mund të shkelë vetëm nënsh mbartësit e saj ose nga personat zyrtarë.

Krahasimi qëndron në atë që ligjvënësi specifikon karakteristikat e sektorit publik dhe privat, duke theksuar rëndësinë mes ndikimeve, që vazhdon me "Abuzimin e detyrës". Megjithatë, akuzat e sipërpërmendura janë ende të diskutueshme, pasi nuk përcaktohet saktësisht duke përfshirë një gamë shumë të gjerë të sjelljeve, që i përfaqëson si shkelje të parimeve të ligjshmërisë dhe kështu të rrezikojë parimet e sundimi i ligjit.

Spektori i privat siguron mbështetje logjistike, pa të cilat ekzistenca e saj, megjithatë dhe funksionimi u sollën në pikëpyetje, ku sektori privat që ka një ndikim të kthyeshëm në sektorin publik.

²⁴Aspektet penale juridike dhe penologjike në legjislacionin pozitiv të Republikës së Serbisë.

KAPITULLI II-të

1. Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit

Shfrytëzim të pozitës zyrtare dhe të autorizimit kemi atëherë kur veprimi i kryerësit të veprës mbetet në kufijtë të autorizimit, por bën keqpërdorim të atyre autorizimeve në atë mënyrë që interesin zyrtar e zëvendëson apo ndërron me interesin e vet personal apo me interesin e dikujt tjetër. Në këtë këndvështrim veprimi i kryerësit na paraqitet si joligjor në aspektin material e jo në atë formal, mbasi nuk kemi të bëjmë me tejkalimin e kufijve të autorizimit apo moszbatimin e pozitës apo autorizimit zyrtar. Shembuj tipik të kësaj forme të keqpërdorimit kemi në ato raste ku personi zyrtar me autorizimin që posedon, për zgjedhjen e ndonjë problemi ka në dispozicion disa metoda, dhe logjikisht si zgjedhje më e mirë do të ishte që ai të zgjedh mënyrën më të volitshme në interes të shërbimit përkatës. Në qoftë se i njëjti në zgjedhjen e metodës për zgjidhjen e problemit përkatës nuk udhëhiqet nga logjika për të mbrojtur interesin e shërbimit, por interesin e tij personal apo dikujt tjetër, me qëllim të përfitoj për vete ose për tjetër person ndonjë dobi ose tjetër kujt do t'i bëj dëm, me këtë veprim personi zyrtar bën keqpërdorim të pozitës zyrtare edhe pse në aspektin formal vepron në suaza të autorizimeve të tij. Që kjo veprë të jetë e kompletuar në aspektin formal juridik duhet të plotësohen edhe disa kushte tjera. Pra për të qenë vepra e kompletuar, si rezultat i veprimeve të bëra nga personat zyrtar pa marr parasysh për cilën formë të saj bëhet fjalë, kusht për të marr trajtën e inkriminimit, është që gjatë veprimeve të tilla kryerësi i veprës të përfitoj për vete ose për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetrit t'i bëj dëm. Dobia ose dëmi mund të jetë në pronë dhe të mira tjera materiale, por mund të shprehen edhe si dobi ose dëm me karakter jomaterial. Paragrafi 1 i keqpërdorimit të pozitës zyrtare që u përmend më lart, është baza e kësaj vepre, dhe në bazë të njëjtit kryerësi i veprës dënohet me burgim prej gjashtë deri në tre vite. Format kualifikuese të kësaj vepre janë të parapara në paragrafin 2, 3, 4 dhe 5, të cilat vijnë në shprehje në varësi të përfitimit apo dëmit si dhe statusit të personit në cilësinë e kryerësit të veprës. Për shembull: në qoftë se kryerësi i veprës do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë apo do të shkaktojë dëm më të madh të pasurisë të tjetërkujt, vjen në shprehje paragrafi i dytë. Kurse në qoftë se kryerësi i veprës përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, atëherë vjen në shprehje paragrafi i tretë i kësaj vepre. Paragrafi i katërt i shtohet kësaj vepre me vonë, si rezultat i asaj se shumë veprime kriminale gjatë periudhës së tranzicionit posaçërisht gjatë privatizimit të ndërmarrjeve mbetën pa u sanksionuar, meqë në atë kohë nuk ishte paraparë përgjegjësi penale për personat përgjegjës në personin juridik. Pikërisht mu për këtë kjo mangësi u

tejkalua në vitin 1999 ku kjo vepër penale u pasurua edhe me paragrafin katërt, ku si shkelës i kësaj forme ligjore sanksionohet edhe personi përgjegjës në personin juridik qoftë ai i huaj apo vendor. Paragrafi i pesë paraqet formën më të rëndë të kësaj veprë, i cili është paraparë me ndryshimin e kodit penal të bërë në vitin 2004 dhe i njëjti sanksionon të gjitha ato keqpërdorime që kanë të bëjnë gjatë kryerjes së furnizimeve publike ku dëmtohet buxheti shtetëror²⁵. Po qe se bëhet një shkelje e tillë kryerësi i veprës do të dënohet më së paku me pesë vite burgim.

Një zyrtar i cili, duke përdorur pozitën e tij zyrtare ose autorizimit, duke tejkaluar kufijtë e autoritetit të tij zyrtare ose duke kryer detyrën e tij zyrtare, fiton për vete ose për ndonjë person tjetër ndonjë përfitim apo shkaqe të tjera dëme, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vite. Kjo vlen për çdo sjellje të personit zyrtar që duke keqpërdorë ose moskryerjen e detyrës, që dëshiron përfitime materiale ose për t'i shkaktuar dëme tjetrit. Për kryerjen e këtij krimi kërkohet paramendim dhe kryesi të ketë dijeni që kryen keqpërdorim dhe abuzim duke përdorur pozitën e tij për të ushtruar tejkalimin ose mos kryerjen e detyrës së tij zyrtare. Si rrethanë rëndues është vendi ku kryesi të marrë përfitime më të mëdha ose të shkaktojë dëme pronësore ose rëndë shkel të drejtat e tjetrit²⁶, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Nëse të ardhurat ose dëmtimi është një shkallë të madhe, atëherë kryerësi dënohet me burgim prej së paku tre vjet. Me të njëjtin dënim do të dënohen dhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në një entitet të huaj juridik që ka një degë ose ushtron biznes në vend ose një person që ushtron veprimtari në Republikën e Maqedonisë ose personi që ushtron interes publik nëse vepra brenda kompetencave ose detyrave të tij. Në rastet kur shkelja është kryer gjatë kryerjes së prokurimit ose dëmtimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit, fondet publike ose pasuritë e tjera të shtetit, dënohet me burgim prej së paku pesë vite. Në kuadër të këtij krimi si shembuj mund të përmenden: falsifikim i dokumenteve zyrtare, keqpërdorim të pozitës për qëllime personale, përfitime pronësore në ushtrimin e shërbimit, mospërbushjes së shërbimit zyrtar që është i detyruar për të kryer, duke vepruar jashtë kufijve kompetencat e zyrtarit dhe të ngjashme. Me nocionin detyrë zyrtare, përveç organeve shtetërore ky nocion vlen edhe për personat juridik me autoritetet publike ndërmarrjet publike, sociale, komunale dhe shërbime të tjera publike. Paraqitje penale konsiderohet njoftimi se është kryer apo është tentuar të kryhet ndonjë vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe eventualisht njoftimi për kryesin e kësaj veprë.

²⁵Kodit penal i Republikës së Maqedonisë.

²⁶Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar, Tetovë, 2009.

2. Keqpërdorimi i shërbimit zyrtar (neni 353)

Vepra ka karakter të përgjithshëm dhe supsidiar. Shumica e veprave tjera nga ky kapitull përbëhen nga keqpërdorimi i pozitës zyrtare. Inkriminuese është keqpërdorimi që kryhet me qëllim të posaçëm për fitim të ndonjë dobie ose shkaktimin e ndonjë dëmi. Në kuptim më të ngushtë në keqpërdorimin e pozitës zyrtare, që i përgjigjet të kuptuarit se qasja jo ligjore e personit zyrtar me motive lakmie është formë e kualifikimit të keqpërdorimit.

Kjo formë vjen në shprehje atëherë kur personi zyrtar me vetëdije, nuk merr veprim zyrtar për të cilën është i autorizuar dhe ka për obligim ta marrë ose në mënyrë formale vepron, në atë mënyrë me ato mjete në atë kohë dhe vend që të mos arrihet qëllimi i paraparë, i cili qëllim do të arrihej në qoftë se personi zyrtar do të vepronte siç duhet. Pra personi zyrtar nuk bën detyrën e tij për të cilën është i autorizuar dhe duhet ta bëj (këtu vjen në shprehje aspekti material dhe formal i moskryerjes së detyrës) apo detyrën zyrtare e kryen në atë mënyrë që të mos arrihet rezultati i cili duhet të arrihej po që se do të veprohej ashtu siç duhej (këtu është ruajtur vetëm aspekti formal).

Personi zyrtar i cili keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Nëse informata zyrtare ka të bëjë me ndonjë veprim të prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton në dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. 5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “informatë zyrtare” nënkupton informatën në të cilën personi ka qasje si rezultat i detyrës apo punës së tij dhe e cila nuk është bërë publike. Mund të konstatojmë se bazë për të caktuar ndonjë veprim a është i inkriminuar janë normat ligjore që përfshin lëmin përkatëse si dhe autorizimet e personave që veprojnë në suazat e atyre normave. Në qoftë se këta persona zyrtar, bëjnë aktivitete kriminale jashtë kornizave ligjore dhe autorizimit të tyre, ata nuk do të përgjigjen për veprë penale keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit zyrtar, por për veprë tjetër konkrete varësisht prej veprimit të tij kriminal.

Që kjo veprë të jetë e kompletuar në aspektin formal juridik duhet të plotësohen edhe disa kushte tjera. Pra për të qenë vepra e kompletuar, si rezultat i veprimeve të bëra nga personat

zyrtar pa marr parasysh për cilën formë të saj bëhet fjalë, kusht për të marr trajtën e inkriminimit, është që gjatë veprimeve të tilla kryerësi i veprës të përfitoj për vete ose për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetrit t'i bëj dëm. Dobia ose dëmi mund të jetë në pronë dhe të mira tjera materiale, por mund të shprehen edhe si dobi ose dëm me karakter jomaterial. Paragrafi 1 i keqpërdorimit të pozitës zyrtare që u përmend më lart, është baza e kësaj vepre, dhe në bazë të njëjtit kryerësi i veprës dënohet me burgim prej gjashtë deri në tre vite. Format kualifikuese të kësaj vepre janë të parapara në paragrafin 2, 3, 4 dhe 5, të cilat vijnë në shprehje në varësi të përfitimit apo dëmit si dhe statusit të personit në cilësinë e kryerësit të veprës. Për shembull: në qoftë se kryerësi i veprës do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë apo do të shkaktojë dëm më të madh të pasurisë të tjetërkujt, vjen në shprehje paragrafi i dytë. Kurse në qoftë se kryerësi i veprës përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, atëherë vjen në shprehje paragrafi i tretë i kësaj vepre. Paragrafi i katërt i shtohet kësaj vepre me vonë, si rezultat i asaj se shumë veprime kriminale gjatë periudhës së tranzicionit posaçërisht gjatë privatizimit të ndërmarreve mbetën pa u sanksionuar, meqë në atë kohë nuk ishte paraparë përgjegjësi penale për personat përgjegjës në personin juridik²⁷. Pikërisht mu për këtë kjo mangësi u tejkalua në vitin 1999 ku kjo vepër penale u pasurua edhe me paragrafin katërt, ku si shkelës i kësaj forme ligjore sanksionohet edhe personi përgjegjës në personin juridik qoftë ai i huaj apo vendor. Paragrafi i pesë paraqet formën më të rëndë të kësaj vepre, i cili është paraparë me ndryshimin e kodit penal të bërë në vitin 2004, dhe i njëjti sanksionon të gjitha ato keqpërdorime që kanë të bëjnë gjatë kryerjes së furnizimeve publike ku dëmtohet buxheti shtetëror. Po që se bëhet një shkelje e tillë kryerësi i veprës do të dënohet më së paku me pesë vjet burgim.

Nga kjo pikëpamje përfundimet si konstatime të nxjerra nga rezultatet e fituara por edhe si njohuri të nxjerra dhe shkencëtarisht të kontrolluara për drejtimit në të cilat duhet të kërkohen vendimet e tyre, në veçanti ata që fitojnë vërtetim edhe nga rezultatet e fituara, janë me rëndësi të madhe.

²⁷<http://www.akademika.com.mk/>

3. Marrja e rryshfetit

Pranimi i rryshfetit (neni 357) - Vepër themelore : e drejta e rryshfetit (par.1). Vepra përbëhet nga kërkesa e drejtpërdrejt ose e tërthortë ose pranimi i dhuratës ose ndonjë dobie nga ana e nëpunësi zyrtar, për kryerësin në suaza të autorizimeve të tij zyrtare të kryejë veprime zyrtare që nuk do duhej ta kryente, ose të mos kryejë veprime zyrtare që do të duhej t'i kryente.

(1) Personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryej një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Personi zyrtar i cili kërkon ose pranon dhuratë ose përfitim tjetër për vete ose për personin tjetër apo që pranon premtimin për dhuratë ose në ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(4) Dhurata apo përfitimi tjetër që është marrë konfiskohen. (Neni 343)

Një tjetër formë e korrupsioni, po ashtu është e lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare. Dallimi në krahasim me formën e mëparshme pasqyrohet në faktin se KP në B dhe H parashikon që një person i cili ka dhënë rryshfet me kërkesë të personit zyrtari, dhe e paraqet atë vepër, mund të përjashtohen nga dënimi, por e njëjta gjë mund të kthehet dhe përsëri t'i kthehet dhurata që i është dhënë. Ata ndryshojnë: e drejtë aktive e rryshfetit, dhe e drejtë joaktive e rryshfetit²⁸.

Veprimi kryer është vetë aktit i mitmarrjes ose premtimeve të veprimeve të tilla. Ekzekutuesi mund të jetë çdo person dhe veprimi bëhet vetëm me paramendim. Te *ratio legis* përfshirja e veprës penale të korrupsionit aktiv në veprat penale kundër detyrës zyrtare, është shprehje e

²⁸Vepra penale mitë-dhënie në legjislacionin kroat dhe praktika gjyqësore - analizë kritike e pjesëve inkriminuese dhe disa propozimeve të De Lege Ferenda, Zagreb, 2001.

përpjekjeve të ligjvënësit për të siguruar një administrim të drejtë dhe të pa korrupsuar jo vetëm nga sjelljet inkriminuese që e bëjnë të pamundur fushëveprimin së suaza të vetë administratës, por edhe kundër të gjitha bashkimeve të paligjshme brenda atyre kornizave që vijnë nga jashtë²⁹.

Kompensimi i ryshfetit pasiv ekziston kur një person zyrtar kërkon një dhuratë apo përfitim tjetër për ekzekutimin e një akti zyrtar që përndryshe duhet apo mund ta kryejë, pikërisht, në rast se nuk e kryejnë një akt që nuk duhet të ekzekutohet. Nga forma e mëparshme, ryshfeti pasiv i drejtë ndryshon në veprime zyrtare me rastin që kërkon ose merr një dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër.

Ryshfeti pasiv ekziston kur një person zyrtar ose përgjegjës u kërkon ose pranon një ryshfet më vonë ekzekutohet ose moskryerjen e detyrës zyrtare, dhe ryshfeti është bërë në lidhje me atë punë. Kjo punë përfshin veprimet zyrtare të dy botëve, dhe qëllimi i inkriminimit në të cilat është parashikuar ligjvënësi është të pengojë zyrtarët që të abuzojnë në detyrën e tyre zyrtare për të marrë dhurata ose përfitime që nuk u përkasin atyre.

Forma e tretë e veprimit është forma më e rëndë në të cilën ndërmjetësi ka marrë një dhuratë ose përfitim tjetër për ndërmjetësim, vlera e së cilës, ligjërisht, është e parëndësishme. Rezultati i nevojshëm është se vepra është kryer, domethënë, ndikim ndaj personit zyrtar të kryejë shërbimit joligjor. Përndryshe, kjo është vetëm një përpjekje.

²⁹Kodi Penal, Pjesa e posaçme, Banja Llukë, 2007

4. Dhënia e rryshfetit

Për më tepër, hulumtimi tregoi se pjesa më e madhe e kryerësve të veprave penale korruptive për nga kombësia janë Maqedonas me 87%. Këtu mund të përmendet edhe përqindja 12.3% në të cilën mund të lajmerohen personat me përkatësi kombëtare shqiptare, përderisa pjesëmarrja e personave me përkatësi kombëtare romë ose kombësi tjetër është e mospërfillur me gjithsej 0.8%.

Nga të dhënat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale korruptive për të theksuar janë edhe rezultatet e hulumtimit sipas të cilave 12% janë persona të akuzuar më herët. Fatkeqësisht hulumtimi nuk dha të dhëna për atë se kthimi u përket veprave penale të njëjtit lloj, që do të ishte më shumë për t'u brengosur sepse tregon në atë se për këto persona edhe pse më janë të gjykuar për këto vepra penale, përsëri janë krijuar rrethana për t'i kryer të njëjtat.

Veprimet ishin analizuar në bazë të tri faktorëve relevant për drejtësinë objektive: minimizim i një anshmërie mbi bazë të njohurive nga procedura gjyqësore, minimizim i efekteve nga rradhitja në prezentimin e dëshmive dhe maksimalizimi i vëllimit dhe saktësia e informatave. Rezultatet tregojnë se efekti i objektivitetit që rezulton nga pritjet e mëparshme është fort i paracaktuar nga hetimi (e sipas hulumtimeve komparative do të ishte dukshëm më i dobët në një procedurë akuzative). Sërish, sipas vëzhguesve, tregohet se në procedurën e tanishme (e a.q.e përzier) ekziston paraqijta jo objektive e fakteve, gjatë së cilës nga rezultatet e analizës që mund të komentohen dhe nga kjo përfundohet se këto procedura çojnë në mbledhjen dhe prezentimin më të mirë të dëshmive. Hetimi sipas rezultateve të projektit ende paraqet “bosht të informatave” në gjithë hetimin i cili e cakton ecurinë dhe përmbajtjen kryesore të diskutimit para gjyqit, ndërsa numri më i madh i aktgjykimeve janë të bazuara pikërisht nga deklaratat e të akuzuarve dhe dëshmitareve të dhëna në hetim³⁰.

Analiza e rezultateve nga vëzhgimi i lëndëve në fushën e korrupsionit në vitin 2009. Duke krahasuar me raportet e mëparshme të Koalicionit. Të gjithë për gjykim të drejtë, si dhe raportet e ngajshme të organizatave tjera ndërkombëtare (OSBE) të cilat merren me vëzhgimin e procedurave gjyqësore dhe përcjelljen e punës së jurisprudencës penale këtë vitë vlerësimet për lëndët vëzhguese janë inkurajuese.

³⁰Muazam H. Aspekte kriminologjike-kriminalistike në keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimeve në R.M.

Me fjalë të tjera, edhe pse kohëzgjatja e proceseve qëndron ende si një dhimbje e pa zgjidhur e gjykatës së vendit, vlerësimet e vëzhguesve për punën e gjyqeve janë pozitive sa i përket çështjeve tjera të rëndësishme, nëse gjykimi dhe dënimet e gjykatësit janë të drejta në një kuptim kryesisht objektiv dhe nëse janë të kënaqshme përkitazi me gjykimin e drejtë. Cila procedurë do të merret si e drejtë mund të varet nga lloji i procedurës së zbatuar dhe nga supozimet që i kemi për mënyrën se si kjo mund të funksionojë. Në një masë të caktuar kuptimi ynë për drejtësi dhe të drejtën janë historikisht të ndërlidhura me folklorin e drejtësisë. Fakti se karakteristikat e caktuara të procedurës gjyqësore e lëndojnë ndjenjën tonë për të drejtë mund të jetë pasqyrë e njohjes me sjellje të llojit të caktuar.

Megjithatë duhet ta kemi parasysh se me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk garantohet vetëm mënyrë e drejtë e procedurës por parashihet edhe një procedurë e një lloji të caktuar publik, të shpejtë dhe objektive, me të drejta të qarta dhe të numëruara elementare të mbrojtjes. Pikërisht sipas këtyre standardeve dhe kriteriumeve të themeluara nga Gjyqi Evropian për të drejtat e njeriut në Strazburg është kryer edhe vlerësimi i proceseve vëzhguese të këtij projekti³¹.

Korrupsioni është fenomen që e shkatëron konceptin për shtet juridik demokratik dhe të drejtave lirive, duke vepruar si barrierë për miratimin e së drejtës ligjore, zbatimin e saj dhe realizimin e së drejtës në raste konkrete. Kjo është çështje më të madhe e shtetit se vetë kriminaliteti në kuptim më të gjerë.

Korrupsioni paraqet goditje të drejtpërdrejtë ndaj rendit kushtetues dhe para së gjithash, ndaj parimeve kushtetuese dhe garancive për të drejtat dhe liritë e njeriut siç është parimi i barazisë së qytetarëve (neni 9 i Kushtetutës) : ushtrimi i autorizimeve zyrtare merr karakter të ushtrimit të shërbimeve të caktuara vetëm për ata qytetarë që mund t'i paguajnë. Përveç elementit të barazisë, nuk ekziston e drejtë njerëzore që nuk mund të rrezikohet nëse mbizotëron principi ajo mund të përjetohet vetëm në masën në të cilën qytetari mund ta blejë (Kambovski, V., Naumovski, P. (2002), 17)³².

³¹Gjykata Evropiane e Drejtësisë është gjykata më e lartë e BE-së. Ajo është formuar në vitin 1952 me formimin e Traktatit të Parisit apo të Tri Komuniteteve për thëngjill dhe çelik, dhe selia e saj gjendet në Luksemburg. Detyra e saj është të siguroj që e drejta e BE-së të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha shtete anëtare. Sipas disa mendimeve pos si institucion që vepron në kuadrin e sistemit komunitar, Gjykata Evropiane e Drejtësisë vepron edhe si gjyq ndërkombëtarë si dhe si gjykatë e brendshme e shteteve anëtare.

³²Kambovski V, Naumovski P, 2002.

Kjo sëmundje në shoqërinë bashkëkohore paraqet kërcënim serioz për shtetet në tranzicion. Kështu që këtë e godasin më tepër faktor, siç janë ndryshimet ekonomike, privatizimi, dobësimi i përgjegjësiave, mosekzistimi i mekanizmave për kontroll efikas dhe sistemi i kontrollit reciprok.

Është paradoksale nga aspekti i alarmimit të çështjes, që në përpjesëtime nacionale, regjionale dhe globale mungon hulumtimi i thellë për implikimet ekonomike, politike dhe implikime tjera të dëmshme të korrupsionit. Në sistemin ku mbizotëron korrupsioni, të drejtat dhe liritë e njeriut degradohen dhe janë sjellë deri në nivelin e “mallrave” të zakonshëm që ka vetëm fructum usus (vlera e përdorimit) e tregut politik, ku nuk mbizotërojnë ligjet e konkurimit, por gjithë është monopolizuar nga ana e pushtetit publik.

Qysh para shqyrtimeve aktuala për korrupsionin mendimtarët e njohur grek Platoni dhe Aristoteli, e kanë zhvilluar mësimin për korrupsionin si prishje e pushtetit, sundim në kundërshtim me interrat e përgjithshme, d.m.th. interesin e bashkësisë politike – shtetin, duke e themeluar besimin e tyre në tezën për ekzistimin e formave të ndryshme të shteteve korruptive³³.

Në letërsinë vendase, vëmendje meriton definicioni i d-r Kambovski dhe d-r Naumovski që çështjes së korrupsionit i kushtojnë një monografi Korrupsioni – e keqja më e madhe e shoqërisë dhe kërcënim për shtetin ligjor, njëherë duke komentuar dhe dispozitat e inagurimit të Ligjit për pengim të korrupsionit dhe Ligjit për pengimin e larjes së parave³⁴. Studimi në mënyrë shtesë është pasuruar me skemën e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Në qasjen e definimit të korrupsionit autorët nuk ngelin vetëm në rrafshin e pikëpamjes së saj si fenomen konservativ, por i përshkruhet më gjerësisht rëndësia politikologjike-sociologjike. Kjo qasje që ndërtohet në bazë të kuptimit të korrupsionit si e keqe e rëndë sociale, fenomen që e rrënon vetë shoqërinë, ekonominë dhe shtetin ligjor, paraqet supozim logjik në kuptimin e plotë të strategjisë preventive-represive për shtypjen e saj Jurisprudencia, në

³³Në filozofinë politike të Platonit dhe Aristotelit deri më sot, në kuptim më të gjerë korrupsioni nënkuptohet si lëshim qëllimesh dhe humbje e legjitimitetit moral dhe politik të një sistemi politik.

³⁴Ligji për pengimin e korrupsionit është sjellë në vitin 2002 dhe që atëherë është ndryshuar dhe plotësuar, Gazetë zyrtare e RM-së, Nr.28/02, 46/04, 126/2006, 10/08, 161/08 dhe 145/10) në raport të Ligjit për pengimin e larjes së parave dhe terrorizmit financiar duke përfshi ligjërimet në lidhje me fenomenin larje parash.

fenomenologjinë e konfiskimit njihet edhe dy forma : konfiskimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë.

Në vitin 1997 është miratuar Konventa për luftën kundër korrupsionit që involvon nëpunës të UE ose të vendeve anëtare të UE³⁵. Instrument me rëndësi paraqet dhe dokumenti i aksionit të përbashkët për inkriminalizim të korrupsionit në sektorin privat nga viti 1998, në drejtim të vendosjes së mekanizmave të harmonizuara për verifikimin e sjelljeve që kanë implikime anti-korrupsion dhe mund të shkaktojnë dëm të subjekteve.

Për forma më të rënda llogaritet mu korrupsioni sistematik që çon drejt rrënimit të vlerave themelore shoqërore. Gjatë orvatjes për përcaktimin e saj, shpesh here, udhëzon në definimin e Klitgaard (1988) që nis nga formula si në vijim :

$$K^{32} = M + D - 0$$

M – monopol (pushtet)

D – diskrecion dhe

P – përgjegjësi

Fjala është për atë formë të korrupsionit që fuqishëm ndikon në mendimin publik dhe vetëdijen publike, shkakton frikë dhe dukshëm e qarkon sistemin e vlerave morale tek qytetarët.

Van Duyne e vendos ndarjen e veprimeve korruptive në nivel intern-ekstern, në rrafshin individual-institucional dhe material, si dhe atë politik dhe psikik. Shpesh, korrupsioni manifestohet në formën e tij eksterne dhe për të është karakteristikë e pagesës së shërbimeve për kryerjen ose moskryerjen e disa veprimeve zyrtare. Forma e korrupsionit ekstern paraqet dhe dhënien në dobi të personave që ndodhen në pozitë të caktuar, pikërisht disponojnë me autorizime që qëndrojnë në lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin e nevojshëm të personit konkret.

- Dhënia e ryshfetit (neni 358).

³⁵Raport i GREKO nga rrethi i tretë i evaluimit (ETS 173 dhe 191, GPC 2), përmban rekomandime në përputhje me të cilat e drejta ndëshkimore gjermane, nevojshëm duhet t'i qaset revidimit të kornizës legislative permanente, në atë rast, tregtia me ndikim do të fitojë autonominë e saj në kontekst të Kodit Penal, më gjerësisht b.Third Evaluation Round Report on Germany on Incriminations.

Dhënia e ryshfetit (ryshfetit aktiv) qëndron në lidhjen e pandashme qenësore me ryshfetin pasiv. Pranimi i ryshfetit d.m.th. lëshim, pëlqim të jesh i korruptuar, derisa dhënia e ryshfetit është korrupsion aktivim nxitje, futja e personit zyrtar në procedurë joligjore.

- Ryshfeti gjatë zgjedhjeve dhe votimeve

Lloji special i keqpërdorimit paraqet inkrimini nga neni 165-a : “Keqpërdorimi i mjeteve për financimin e kampanjës zgjedhore”.

Dhënja e çmimit për ndikim joligjor (neni 358-a). Rëndësia e veprës dhe objekti i mbrojtjes.

Bazë më e rëndësishme ndërkombëtare për inkriminin e veprimeve të tilla paraqet Konventa e SE dhe Konventa e KB. Konventa e SE në dispozitën nga neni 12 “ndikim në ushtrim”, përmban detyrim për inkriminim të veprimeve që përbëhen nga premtimi, ofrimi ose dhënja e drejtpërdrejt ose e tërthortë, e një nëpunësi publik ose personi tjetër, dobi pronësore jo meritore për shkak të keqpërdorimit të ndikimit të tij me qëllim të përfitimit nga organi udhëheqës ose organi shtetëror, dobi jo meritore për motivuesin ose personin tjetër, kërkesë ose pranim nga ana e nëpunësit publik ose personit tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dobi jo meritore për veti ose për tjetër me qëllim të keqpërdorimit të ndikimit të nëpunësit publik ose personit tjetër për përfitime me dobi jo meritore nga organi udhëheqës ose organi shtetëror.

Nga aspekti i së drejtës ndëshkimore pozitive, risi me rëndësi që prekin këtë temë, janë kryer me Novelën e KPM nga viti 2011, në atë kuptim që u bë qasje në vendosjen e veprave të reja ndëshkimore dhe redefinim të inkriminimeve permanente nga sfera e korrupsionit. Bazë kalimtare për reformë paraqesin dispozitat e dokumenteve ndërkombëtare dhe rekomandimeve GRECO (më saktë, Rekomandimi V)³⁵ në përputhje me tregtinë me ndikim të ashtu quajtura format e saj të shfaqjes meritojnë pozitë autonome në sistematizimin e veprave ndëshkimore korruptive.

Risi paraqet inkriminimi nga neni 358-a : “dhënia e çmimit për ndikime jo ligjore”.

Në përputhje me ligjin, dispozitat nga parag.1 e inkriminojnë ndikimin aktiv jo ligjor³⁶. Veprimi i kryerjes së dhënies, çmimit ose dobisë tjetër personit që me shfrytëzimin e ndikimit të tij, duhet të ndikojë të kryhet veprim zyrtar ligjor.

³⁶Me ndryshimet e fundit të KP nga dhjetori i vitit 2012 janë kryer intervenime teknike në atë kuptim që titulli “Dhënie e çmimit për ndikime jo ligjore” vihet para nenit.

Çmimi, dhurata ose dobia tjetër mund të përbëhet në pagesën, premtimet ose ofrim parash ose dobi tjetër materiale dhe jo materiale. Dobie i jepet, premtohet ose i ofrohet personit që mund ta shfrytëzojë ndikimin e tij të supozuar ose real, pozita zyrtare ose shoqërore dhe reputacion, që të ndikojë për kryerjen e veprimit të caktuar zyrtar. Ndikimi mund të përbëhet në kërkesë, intervenim, nxitje ose veprim tjetër, me të cilin mund të shkaktohet te personi zyrtar vendimi për kryerjen e veprimit zyrtar.

Kështu duhet të punohet, ashtu që, për veprimin zyrtar që edhe ashtu do të duhej të kryhej, pikërisht mos kryerja e veprimit zyrtar që nuk do të mund të kryhej.

5. Falsifikimi i dokumentit zyrtar/parave

Për sa i përket dispozitave objekt shqyrtimi, neni 190 i KP-së, në formulimin e tij fillestar, parashikonte për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve dënimin me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Ndërsa neni 191 i KP-së, për veprën penale të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, parashikonte dënimin me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Parashikimi njëkohësisht i dy dënimeve kryesore u përdor nga ligjvënësi edhe në ndryshimet e mëvonshme të Kodit Penal në vitet 2007, 2008 si dhe në ndryshimet e fundit të miratuara në vitin 2012. Si pasojë, një sërë dispozitash të Kodit Penal, aktualisht, parashikojnë sanksionimin njëkohësisht të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë. Në vijim të kësaj premise, duke qenë se rendet juridike evropiane bazojnë përgjithësisht sistemin e tyre të dënimeve mbi një bashkësi figurash ndëshkuese të shumta, Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim, në mënyrë të përmbledhur, përmbajtjen e dispozitave të disa prej këtyre vendeve, duke i krahasuar me dispozitat objekt shqyrtimi.

Edhe pse vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Maqedoninë, kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të zhvilluar dhe forcuar sistemet e tyre për parandalim të korrupsionit, përparimi i tyre është i ngadalshëm dhe shpesh mbetet vetëm në letër, thuhet në raportin e fundit të Transparency International. Instituti për Demokraci dhe Zhvillimi “Societas Civilis” si pjesë e konzoriumit të univeriteteve dhe organizatave të udhëhequra nga Universiteti “Kolegji i Londrës” ka zbatuar hulumtim shkencor ndërkombëtar që ka përfshirë pesë sfera. Në sferën e politikës ka ardhur në përfundim se fuqizimi i legjislativit dhe zbatimi në masë të madhe të tij nuk do të jetë i mjaftueshëm kundrejt shkallës së korrupsionit aktual në

Maqedoni dhe në shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Në raport konkludohet se partitë politike janë më pak transparente. Ata posedojnë fuqi më të madhe, por është e vështirë të dënohen për korrupsion. Megjithatë partitë politike premtojnë se do të luftojnë korrupsionin dhe do të fokusohen në zbatimin e reformave paralajmëruese. Ja qëndrimet e atyre partive që kanë publike platformat politike. Në raportin e publikuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni në vitin 2014³⁷, vërehet ulje e nivelit të korrupsionit në krahasim me vitin 2002, kur edhe është kryer hulumtimi i fundit i këtij lloji.

Hulumtimi bazohet në anketat që janë bërë në popullatë dhe në sektorin e biznesit. Korrupsioni është renditur si problemi i pestë më i madh i shtetit, pas papunësisë, varfërisë, të ardhurat e ulëta dhe çmimet e larta. Vlen të theksohet fakti që shifrat kanë të bëjnë me perceptimet e qytetarëve, andaj kjo ulje e raportuar mund të jetë për shkak të lajmërimit më të vogël në media. Falsifikimi bëhet në aso përmasash që mund të ndikojnë negativisht në sistemin ekonomik të vendeve të caktuar, duke shkaktuar probleme në politikën monetare. Motivet dhe qëllimet kryesore të falsifikimit të parave janë të natyrës ekonomike dhe politike. Interesi ekonomik është i dukshëm, sepse fitimi në raport me punën dhe mjetet e investuara është i madh, pavarësisht prej rrezikut se kjo veprimtari kriminale mund të zbulohet³⁸. Siç vërejnë studiuesit, falsifikimi është punë shumë e rëndësishme sepse interesi gjendet midis mundit të prodhimit dhe fitimit që arrihet me vënien në qarkullim të parave të falsifikuara. Alarmante është situata në sferën e biznesit ku sipas përfaqësuesve të biznesit, një kompani mesatarisht paguan 900 euro ryshfet gjatë vitit. Sipas Entit Shtetëror të statistikës, numri i bizneseve aktive në Maqedoni në vitin 2013 ka qenë 71,290.

Termi pastrim i parave (Money Laundering), në kuptimin që ka sot, për herë të parë është përdorur në SHBA në vitet 70-80 të shekullit të kaluar. Shfaqja e një dukurie të tillë erdhi si pasojë e rritjes së të ardhurave të grupimeve kriminale nga tregtia e paligjshme e lëndëve narkotike dhe e nga riinvestimi i tyre në ekonominë e ligjshme amerikane. Kjo dukuri u emërtua si transformim i parave të pista, të përfituara në rrugë jo të ligjshme, në para të pastra” që kishin prejardhje “të ligjshme” dhe që mund të hynin lirisht në qarkullimin“monetar.

³⁷QMBN për vlerësim të korrupsionit në vitin 2014.

³⁸Bazat e kriminalitetit ekonomik, Mersida S., Prishtinë 2006.

Kjo dukuri u emërtua si transformim i parave të pista, të përfituara në rrugë jo të ligjshme, në para të “pastra” që kishin prejardhje “të ligjshme” dhe që mund të hynin lirisht në qarkullimin monetar⁴⁰. Ligjësimi i mjeteve monetare dhe i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme ose siç quhet “pastrimi i parave të pista” është një tjetër formë e shfaqjes së veprimtarisë së krimit të organizuar dhe përbërëse e korrupsionit, që parashikohet në legjislacionin penal³⁹. Thelbi i këtij veprimi kriminal qëndron në synimin, që nëpërmjet veprimtarisë së kundërligjshme t’i krijojnë kushte pronarit të mjeteve monetare apo të pasurive të fituara në rrugë kriminale, që t’i gëzojë ato sikur të ishin përfitime të ligjshme. Kryerësit e kësaj vepre penale mëtojnë që burimin real të të ardhurave ta fshehin për ta krijuar kështu një burim tjetër, gjoja se pasuria prej tani e tutje do të fillojë të shumëzohet. Njëherësh, pastrimi i parave shërben edhe për financimin e grupeve terroriste, mbase në ditët e sotme një veprimtari e tillë kriminale me të madhe është duke u realizuar. Për këtë qëllim përdoren mjete dhe metoda nga më të ndryshmet, ku do të veçojmë taktikat e futjes në qarkullim dhe në riqarkullim të parave që kanë rrjedhur nga veprimtaria kriminale.

Kjo vepër realizohet nëpërmjet këtyre veprimeve, si : - Depozitimit, tjetërsimit, transferimit ose këmbimit të parave me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale. - Fitimin e së drejtës së pronësisë mbi çdo lloj pasurie, që rrjedh nga veprimtaria kriminale apo nëpërmjet përdorimit të parave të papastra, natyrisht kur subjekti ka njohuri. - Ndërmjetësimi në favor të një personi tjetër për depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe këmbimin e mjeteve monetare, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë ose të origjinës që rrjedh nga veprimtaria kriminale. Ligjësimi i parave të papastra rëndom bëhet përmes rrugës institucionale, duke gravituar kështu edhe persona me autoritet të politikës së vendit. Vende të preferuara për pastrim të parave janë shtetet me politikë jostabile dhe me ekonomi të pazhvilluar, ku ata që dëshirojnë të investojnë në kësi lloj shtetesh, shpeshherë qëllimisht harrohen të pyeten për burimin e atyre mjeteve që synohen të investohen nëpër veprimtari tregtare apo prodhuese në vendin përkatës. Kështu, fjala bie, vendet e Ballkanit Perëndimor janë vende tejet të përshtatshme për shpëlarje parash, duke mos i mënjanuar edhe vendet e tjera, që gjenden në “hallin” e njëjtë të këtyre vendeve, me përjashtim të ndonjë metode dhe mënyre shtesë apo të mangët.

⁴⁰Iljasa Salihu “Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik”, Shkup – 2012.

KAPITULLI III-të

1. Roli i prokurorit në parandalimin e veprës penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare

Realizimi i efektivitetit të ligjit penal kundër kriminalitetit lidhet dhe varet nga funksionimi normal i organeve të prokurorisë. Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm, si strukturë e centralizuar. Struktura e Prokurorisë përbëhet nga: a. Prokuroria e Përgjithshme b. Prokuroria e Lartë Publike c. Prokuroria Themelore Publike. Prokuroritë janë të organizuara dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor. Funksioni i prokurorit kërkohet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur, punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundër të gjithë pjesëmarrësve në procesin penal si dhe organeve të tjera shtetërore. Efektiviteti i veprimtarisë së prokurorisë në luftimin e kriminalitetit pasqyrohet në vëllimin e punës së kryer gjatë pesëvjeçarit të fundit. Veprimtaria e prokurorisë për luftimin e kriminalitetit zhvillohet në disa faza të procesit të hetimeve paraprake, sipas normave të Kodit të Procedurës Penale. Studimi dhe kontrolli i rasteve kur fillon procedimi penal ose mosfillimi i procedimit, pushimit, pezullimit dhe dërgimit të çështjes penale në gjykatë si dhe mbrojtja e akuzës në gjykatë në emër të shtetit kanë rëndësi të veçantë, sepse janë tregues i efektivitetit të legjislacionit penal dhe sistemit të drejtësisë në luftimin e kriminalitetit. Por, në rast se prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal ose pezullimin apo pushimin, atëherë është pezulluar ose ka pushuar së vepruari edhe efektiviteti i ligjit penal në luftimin e kriminalitetit.

Në Republikën e Maqedonisë më i shpeshtuar është korrupsioni që paraqitet në formën e keqpërdorimit dhe shfrytëzimit kundërligjor të detyrës zyrtare dhe autorizimit që dalin nga ajo, për dallim nga deliktet tradicionale korruptive⁴¹. Prokurorët publik rrallë dorëzohen nga akuzat. Në lidhje me zbatimin e masave të posaçme hetimore mbahet kostatimi i vitit të kaluar se këto masa të posaçme hetimore përdoren në numër mjaft restriktiv.

⁴¹Ismail, Z. - Disa karakteristika të korrupsionit dhe pengimi i tij, Proceset e eurointegritit euroatlantik dhe Maqedonia CRPS – Tetovë, 2008.

Në ndryshimet që u bënë kohët e fundit në drejtimin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të disa prokurorëve, duke vënë si kriter themelor integritetin moral dhe meritokracinë ka filluar reformimi i platformës së punës, për ta bërë sa më efektiv rolin e prokurorisë në goditjen e kriminalitetit dhe parandalimin e tij, për të fituar besimin e publikut. Për këtë arsye është theksuar se prioriteti kryesor është luftimi i korrupsionit brenda dhe jashtë rradhëve të saj. Njëkohësisht i është dhënë përparësi krimit të organizuar, trafikeve të narkotikëve dhe të qenieve njerëzore, femrave e fëmijëve, pastrimit të produkteve të veprës penale, dhunës në familje, si problem shqetësues si dhe krimit të rrugës. Kryerja e këtyre objektivave dhe të tjerave që diktohen nga praktika e punës së përditshme është një bazë e fuqishme për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së prokurorisë në zbatimin e ligjit dhe luftimin e kriminalitetit e parandalimin e tij . Problem i mprehtë dhe mjaft i diskutueshëm është raporti midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë, sipas ligjit që lejon kontrollin paralel të dy institucioneve mbi veprimtarinë e prokurorëve⁴².

(1) E drejta dhe obligimi themelor i prokurorit publik është që t'i ndjekë kryerësit e veprave penale për të cilët ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare. (2) Në lëndët e veprave penale për të cilat ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare, prokurori publik ka të drejtë dhe obligim: - t'i drejtojë veprimet e organeve kompetente për zbulimin dhe paraqitjen e veprave penale dhe kryerësve të tyre; - të propozojë ose japë urdhër për ndërmarrjen e masave të veçanta hetimore, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj; - të japë urdhra dhe të zbatojë procedurë hetimore; - të gjejë, propozojë dhe të sigurojë prova, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj; - të propozojë masa të përkohshme për sigurimin e pronës ose sendeve të marra me veprën penale ose për zbatimin e masës së konfiskimit; - të vendosë për prolongimin e ndjekjes penale nën kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me këtë ligj; - të propozojë lëshimin e urdhëndëshkimit nën kushtet të përcaktuara me këtë ligj; - të negociojë dhe të merret vesh me të akuzuarin për pranimin e fajit, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj; - të parashtrijë dhe përfaqësojë aktakuza para gjykatës kompetente; - të parashtrijë ankesa kundër vendimeve gjyqësore jo të plotfuqishme dhe mjete juridike të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore të plotfuqishme; - të vendosë për ankesën e të dëmtuarit; - të ndërmarrë edhe veprime tjera të përcaktuara me ligj. (3) Prokurori publik ngrit procedura të veçanta dhe merr pjesë në to kur kjo është përcaktuar me ligj të posaçëm.

⁴²Jaho, N. - Ekzekutivi kontrollon Prokurorinë, 24 janar 2012

Interesante për të theksuar është edhe fakti se veprat penale tipike, për *definitionem* me të cilat karakterizohet korrupsioni, e ato janë marrja e mitos, dhënia e mitos dhe vepra penale ndërmjetësim jashtëligjor që janë ne veçanti të rralla në kuadër të lëndëve të vëzhguara, përkatësisht nga gjithsej 110 lëndë, të vëzhguara janë vetëm 3, që tregojnë se në Republikën e Maqedonisë më i shpeshtuar është korrupsioni i cili paraqitet në formën e keqpërdorimit ose shfrytëzimit kundërligjor të detyrës dhe autorizimeve që burojnë nga ajo, për dallim nga deliktet tradicionale korruptuese⁴³. Ky është njëri nga përfundimet e mundshme dhe i dyti është se keto forma, thjeshtë janë të fshehura prapa këtyre veprave ose janë pjesë përberëse e saj, njëherit janë të rënda për detektim nga ana e organeve të përndjekjes.

Nga karakteristikat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale nga fusha e korrupsionit hulumtimi përfshiu pyetje lidhur me moshën, vendin ku banon, kombësinë e të akuzuarit, si dhe arsimimin e tyre dhe gjykimin e mëparshëm.

Lidhur me pyetjen për moshën, edhe pse janë të përfaqësuar gati të gjithë grupmoshat, prapëseprap në përqindje më të madhe si kryerës të veprave penale korruptuese paraqiten personat të cilat i takojnë grupmoshës 45 deri 55 vjet (36.2%) dhe prej 36 deri 45 vjet (31%). Më e vogël është pjesëmarrja e grupmoshës prej 18 deri 25 vjet (1.7%) dhe të asaj mbi 66 vjet (4%).

Hulumtimi tregon se përqindja më e madhe e kryerësve janë me arsim të lartë (57.7%), por i madhë është edhe numri i atyre kryerësve të cilët janë magjistër të shkencave (32.5%). Si kryerës të veprave penale korruptive, që vërtetojnë edhe rezultatet e hulumtimit, më rrallë paraqiten persona me arsim fillor (2%) dhe arsim të mesëm (1,5%)⁴⁴.

Sipas vendit të banimit kryerësit e veprave penale të korrupsionit më së shpeshti i lokalizojmë në mjediset qytetare. Pikërisht, ky hulumtim tregonë se edhe pse me pjesëmarrje të ndryshme, megjithatë të përfaqësuara janë më tepër qytetet e Republikës së Maqedonisë edhe atë me përqindje më të lartë dallohet Strumica (23.4%), Manastiri (17.5%), Velesi (13%) dhe Shkupi (11%). Lëndët tjera bien në kryerësit të cilët jetojnë në mjediset qytetare, me përjashtim të atyre të parëndësishëm (2%). Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit të zbatuara dhe të prezentuara më lartë mund të konstatohet se analiza e të dhënave të paraqitura, në raport me

⁴³Efikasiteti i sistemit gjyqësor në përballimin e korrupsionit në RM, Shkup 2010.

⁴⁴Muazam H. Aspekte kriminologjike-kriminalistike në keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimeve në R.M.

moshën, arsimimin dhe vendin e banimit, tregojnë atë se ato janë krejtësisht logjike nëse kemi parasysh karakterin e posaçëm të këtyre veprave penale, përkatësisht mënyrën se si ato mund të kryhen si dhe veçoritë që mund t'i ketë kryerësi i tyre. Pikërisht për atë pritet që grupmosha prej 36 deri 55 vite do të paraqitet si kryerës me i shpeshtuar i këtyre veprave penale. Njëherit, për atë që ato janë persona të cilët janë në pozita të larta udhëheqëse. Kuptohet që ato të jenë me arsim të lartë, madje edhe bartës të gradave shkencore. Për më tepër, hulumtimi tregoi se pjesa më e madhe e kryerësve të veprave penale korruptive për nga kombësia janë Maqedonas me 87%. Këtu mund të përmendet edhe përqindja 12.3% në të cilën mund të lajmerohen personat me përkatësi kombëtare shqiptare, përderisa pjesëmarrja e personave me përkatësi kombëtare romë ose kombësi tjetër është e mospërfillur me gjithsej 0.8%.

Nga të dhënat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale korruptive për të theksuar janë edhe rezultatet e hulumtimit sipas të cilave 12% janë persona të akuzuar më herët. Fatkeqësisht hulumtimi nuk dha të dhëna për atë se kthimi u përket veprave penale të njëjtit lloj, që do të ishte më shumë për t'u brengosur sepse tregojnë në atë se për këto persona edhe pse më janë të gjykuar për këto vepra penale, përsëri janë krijuar rrethana për t'i kryer të njëjtat⁴⁵.

Veprimet ishin analizuar në bazë të tri faktorëve relevant për drejtësinë objektive: minimizim i një anshmërie mbi bazë të njohurive nga procedura gjyqësore, minimizim i efekteve nga rradhitja në prezentimin e dëshmive dhe maksimalizimi i vëllimit dhe saktësia e informatave. Rezultatet tregojnë se efekti i objektivitetit që rezulton nga pritjet e mëparshme është fort i paracaktuar nga hetimi (e sipas hulumtimeve komparative do të ishte dukshëm më i dobët në një procedurë akuzative). Sërish, sipas vëzhguesve, tregohet se në procedurën e tanishme (e a.q.e përzier) ekziston paraqitja jo objektive e fakteve, gjatë së cilës nga rezultatet e analizës që mund të komentohen dhe nga kjo përfundohet se këto procedura çojnë në mbledhjen dhe prezentimin më të mirë të dëshmive. Hetimi sipas rezultateve të projektit ende paraqet “bosht të informatave” në gjithë hetimin i cili e cakton ecurinë dhe përmbajtjen kryesore të diskutimit para gjyqit, ndërsa numri më i madh i aktgjykimeve janë të bazuara pikërisht nga deklaratat e të akuzuarve dhe dëshmitareve të dhëna në hetim⁴⁶.

⁴⁵Sadin H.-Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimeve si formë e veçantë e kriminalitetit.

⁴⁶Hulumtimi përfshiu të dhëna të lëndëve të vëzhguara në periudhën 01.04.2009-31.12.2009.

2. Roli i gjykatave në parandalimin e veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare

Duke pasur parasysh Ligjin për ndryshime dhe plotësime të LVPMRM të vitit 2008 me të cilin u zgjerua mundësia për përdorimin e masave të posaçme hetuese, në pajtim me nenin e ndryshuar 142_6 të LVPRM masat e posaçme hetuese mund të zbatohen përkaj veprave penale, ku ligji parasheh dënim me burg se paku 4 vite dhe për veprat penale për të cilat ekziston dyshimi se janë duke u përgaditur, në rrjedhë është kryerja ose është kryer veprë penale nga ana e grupit të organizuar, bande ose shoqëri tjetër kriminele, si dhe për vepra tjera penale të caktuara, keqpërdorim të detyrës, ose autorizimit si dhe për delikte të caktuara të korrupsionit, mes të cilave edhe veprat penale keqpërdorim të detyrës dhe autorizimit nga neni 353, Vjedhje në detyrë nga neni 354, Mashtrim në detyrë nga neni 355, Shërbim në detyrë nga neni 356, Mitë-marrje nga neni 357, Mitë-dhënie nga neni 358, Ndërmjetësim jashtëligjor nga neni 359 etj. Prapëseprapë përdorimi i gjerë për repertoarin e caktuar të veprave penale është i kufizuar me detyrimin për përdorimin e këtyre masave vetëm nëse në mënyre tjetër nuk do të mund të siguroheshin dëshmitë se personat për të cilët ekziston dyshimi janë kryerës të veprave penale. Në lidhje me zbatimin e masave të posaçme hetuese tek lëndët e vëzhguara nuk është evidente rritja e veçante në raport me përdorimin e tyre krahasuar me atë të vitit të kaluar. Kështu që sipas lëndëve të vëzhguara para Gjykatave Themelore nga ana e anëtareve të Koalicionit, nga gjithsej 110 lëndë masat e posaçme hetuese janë përdorur në tri lëndë. Nëse krahasohet me raportin e vitit të kaluar, qëndron konstatimi se zbatimi i këtyre masave të posaçme hetuese është mjaft restriktiv dhe i kufizuar⁴⁷. Ky është një përfundim i mirë duke pasur parasysh rrezikun i cili gjurmon gjatë zbatimit joadekuat të masave të posaçme hetuese të cilët gjatë zbatimit jokritik, selektiv ose jokontrollues kanosen të paraqesin goditje më të madhe në sferën e privatësisë dhe shkelje ndaj të drejtave dhe lirive të garantuara kushtetuese të qytetarëve. Në raport me lëndët penale për të cilat janë të caktuara këto vepra penale janë : një lëndë për mitë marrje, një lëndë ku të akuzuarit akuzohen për kryerje të dy veprave penale dhe atë shoqëri kriminele dhe keqpërdorim të detyrës dhe autorizimit dhe një lëndë për veprë penale keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit. Gjatë kësaj vetëm lënda në të cilën të akuzuarit akuzohen për veprat penale shoqëri kriminele dhe keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit daton që nga viti 2008, përderisa dy lëndët tjera janë nga viti 2009⁴⁸.

⁴⁷Neni 37, Ligji mbi Gjykatat, Fletorja zyrtare e RM nr.58/2006, 35/2008, 150/2010.

⁴⁸Shiko;në 6 Fq.1 te KEDNJ; në.10 nga Deklarata univerzale; në14 Fq.1te PNDNJ

Duke pasur parasysh situatën aktuale me shumë kontradikta rreth pavarësisë së gjykatave, vëmendjën tone e fokusojmë mbi pavarësinë dhe mosprivilegimin në gjykatë. Në atë kuptim, test ultimativ për pavarësinë është pavarësia funksionale në praktikën gjyqësore dhe lirinë faktike të instruksioneve në kryerjen e funksioneve gjyqësore⁴⁹. Nga ana tjetër, pavarësia personale e gjykatësve edhe pse e mbrojtur në disa aspekte të saj nuk garanton imunitet të çfardo ndikimeve nga ana e pushtetit ekzekutiv. Në atë kuptim, edhe pse ndërhyrje e hapur e pushtetit ekzekutiv në jurisprudencë nuk mund të tolerohet, intervenime më suptile të pushtetit ekzekutiv ose faktorë tjerë ose qendra të fuqishme vëzhguesit vështirë mund ti regjistrojnë. Prapëseprapë, fakti që në secilën lëndë të dytë të vëzhguar ekzistonte njëfarë dyshimi në paanshmërinë e gjyqit është e rëndësishme dhe brenguese. Ky moment nga njëra anë hedh hije mbi vlerësimin e mirë për drejtësinë e procedurave dhe dënimeve sepse tregon në jokonzistencën e caktuar logjike të rezultateve dhe kërkon analizë plotësuese dhe revision të mundshëm të instrumentariumit të matur në ardhmëri. Paanshmëria e gjykatës është e operacionalizuar në tre mënyra : si mosekzistencë të jo objektivitetit, si ndershmëri dhe krijim i rezistencës për të qenë i drejtë. Mos ekzistimi i objektivitetit në procedimin e pushtetit gjyqësor është e formuar pyetja se të akuzuarit a kanë qenë të trajtuar ndryshe në varshmëri me racën e tyre, gjininë, moshën, kombësinë ose nga ndonjë veçori tjetër personale. Jo objektiviteti në kuptim të ndershmërisë është i vlerësuar nëpërmjet përgjigjeve të pyetjes, vallë pushteti ka ndërmarrës diçka që ka qenë e parregullt ose e pandershme dhe e dyta, policët, të akuzuarit ose gjyqtarët a kanë provuar të tregojnë sjellje të drejtë. Saktësia e kualitetit në vendosje është e vërtetuar me përgjigjet e pyetjes se a i ka pasur gjykata informatat e duhura për të marrë një vendim të drejtë. Rezultatet e analizës tregojnë se disa aspekte të drejtësisë procedurale kanë pasur kontribut të pavarur ndaj vlerësimit të vëzhguesve : orvatja që pushteti ka bërë përpjekje për të qenë i drejtë : ndershmëria e tyre, vlerësimi se a ka qenë konzistent me vënien e tyre në përputhje me standardet etike, a është dhënë mundësia për paraqitje, kualiteti i vendimeve të marra, a ekziston mundësia për ankesë dhe se a është treguar subjektivitet në sjelljen e pushtetit, ose objektivitetit, a është treguar se jo objektiviteti është i rëndësishëm, në më shumë forma të objektivitetit subjektiv, përpjekje për të qenë i drejtë dhe i ndershëm, sesa si vlerësim i drejtpërdrejtë për shkallën e objektivitetit të pushtetit. Metodika kriminalistike, në zbulimin, ndriçimin dhe sqarimin e veprave penale dhe kryerësve të kriminalitetit seksual, paraqet një formë të veçantë të

⁴⁹Ismail, Z. - E drejta penale – pjesa e posaçme, Tetovë, 2008

zbatimit profesional të masave taktiko-kriminalistike dhe të metodave dhe mjeteve të tjera teknike-kriminalistike. Metodika kriminalistike, në zbulimin, ndriçimin dhe sqarimin e veprave penale dhe kryerësve të kriminalitetit seksual, paraqet një formë të veçantë të zbatimit profesional të masave taktiko-kriminalistike dhe të metodave dhe mjeteve të tjera teknike-kriminalistike. Të gjitha këto veprimtari nën mbikëqyrjen e policisë, më vonë masat dhe veprimet që urdhëron prokurori i shtetit në fazën paraprake hetimore dhe në procedurën gjyqësore, janë të kushtëzuara nga bashkëpunimi i organizuar i të gjitha këtyre organeve në zbulimin, ndriçimin dhe gjykimin e kryerësve të veprave penale. Një rol shumë të rëndësishëm ka prokuroria e shtetit si organ i pavarur, e cila është përgjegjëse për hetimin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare (ex-officio), apo edhe me propozimin e të dëmtuarit, po ashtu prokurori i shtetit është përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes së kryerësve të tyre dhe për mbikëqyrjen e policisë gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për mbledhjen e të dhënave e informacioneve për fillimin e procedurës penale⁴⁴.

Zbulimi dhe ndriçimi i veprave penale kundër integritetit seksual i përket veprimtarisë së policisë primare por edhe organeve të tjera të represionit- prokurorisë dhe gjykatës. Zbulimi i veprave penale ka për qëllim që nga dyshimet më të ulëta të arrihet te shkalla më e lartë e dyshimit, gjegjësisht dyshimit të bazuar mbi krimin dhe kryerësin. Kjo veprimtari kryhet në kuadër të procedurës paraprake. Hapja dhe zhvillimi i procedurës paraprake është e lidhur me kushtin e paraqitjes së bazave të dyshimit mbi ekzistimin e veprës penale.

Duke pasur parasysh se media ka një funksion të ndryshëm nga policia në shoqëri dhe se nuk u nënshtrohet detyrimeve dhe përgjegjësi të njëjta, policia nuk duhet të tentojë të përdorë gazetarët si burime informacioni në hetime duke përjashtuar rastet kur informacioni botohet në media. Nuk përjashtohet fakti se gazetarët shpesh mund të jenë vetë subjekte të një hetimi penal. E drejta e gazetarëve për të përdorur dhe mbrojtur burimet anonime të informacionit duhet të respektohet gjithmonë nga policia. Nga ana tjetër, Policia duhet të pranojë se puna e medias për vënien para përgjegjësisë të organeve qeveritare do të përfshijë edhe raportimin e punës së policisë, që shpesh mund të ekspozojë abuzim apo korrupsion brenda radhëve të saj.

Kufijtë ndërmjet konformizmit dhe deviacionit gjithmonë për hulumtuesit kanë paraqitur sfida.

Debatet mbi devijimet fillojnë nga mendimet të cilat me këtë nocion nënkuptojnë të gjithë individët në shoqëri të cilët nuk i zbatojnë normat pozitive-juridike dhe kërkesat e shumicës

në grupin e caktuar. Lidhur me këtë për devijimin flitet në kuptim të dyfishtë. Këtu mendojmë në shmangiet të cilat mund të jenë pozitivisht të sanksionuara (të shpërblyera) apo mund të jenë të sanksionuara (të gjykuara). Disa orientime të reja socio-kriminologjike brenda tipologjisë së deviacionit e radhitin këtu edhe deviacionin neutral të cilin shoqëria e miraton pa shpërblim apo pa sanksion eventual. Në jetën e përditshme devijimi zakonisht lidhet për ato sjellje të cilat rezultojnë me tipin negativ të sanksionit. Disa kriminolog dhe sociolog kanë propozuar që termi devijim të kufizohet dhe rezervohet ekskluzivisht për situatat në të cilat sjellja e caktuar zhvillohet në drejtimin e papranueshëm. Këto mendime para së gjithash janë të orientuara në atë tip të sjelljes dhe atë shkallë e cila tejkalon kufijtë e tolerancës brenda bashkësisë së caktuar shoqërore.

Nga konstatimet e lartpërmendura mund të përfundohet se devijimi është kategori relative gjegjësisht se nuk ekziston mënyrë universale e identifikimit të aktit devijant dhe distinkcionit të tij nga ajo normale. Prandaj lidhur me këtë devijimi në parim provohet të definohet në raport me ndonjë standard të përcaktuar më parë. Duke pasur parasysh faktin se në kuptimin sociologjik të fjalës nuk ekzistojnë standarde brenda shoqërive të caktuara të cilat do të mund të karakterizoheshin si fikse dhe absolute, devijimi në mënyrë të pashmangshme lëviz nga koha në kohë gjegjësisht nga vendi në vend.

Me fjalë tjera sjellja devijante është e determinuar me kulturën, kurse kultura si formë e vetëdijes shoqërore gjithashtu është kategori variabile apo e ndryshueshme. Ndonëse devijimi definohet si kategori relative dhe në kuptimin e gjerë si sjellje asociale, vëmendja jonë këtu është e drejtuar në sjelljet kundërligjore të cilat shoqëria konkrete i inkriminon brenda ligjit penal⁵⁰. Kriteri themelor për dallimin e devijimit nga krimi sikurse në përkthim të thjeshtë nga termi burimor latin e quajmë sjellje kundërligjore, gjendet në faktin se krimi rrezikon vlerat themelore të shoqërisë dhe ekzistencën e saj, ndërsa rreziku shoqëror tek devijimi është i shprehur në një masë shumë më të vogël. Krimi pashmangshëm alarmon mekanizmin e tërësishëm të kontrollit formal shoqëror, ndërsa devijimi zakonisht sanksionohet me kontrollin joformal shoqëror.

⁵⁰Shoemaker, D. , Theories of Delinquency, Oxford University Press-New York, 1984.

I., Sociologjia, FKN-Sarajevë, 1997.

3. Roli i mas-medieve në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës zyrtare

Në mungesë të llogaridhënies së fuqishme horizontale dhe mekanizmave funksionalë të zbatimit të ligjit, është edhe më vendimtare që aktorët jo-shtetërorë të kenë si kapacitetin, ashtu edhe lirinë për t'iu kërkuar llogari aktorëve politikë. Megjithatë, të dyja, si media, ashtu edhe shoqëria civile, vuajnë nga forma të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të presionit në të gjithë rajonin, duke përfshirë kërcënime fizike dhe sulme (Shqipëri, B&H, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Turqi); fushata njollosjeje dhe padi për shpifje (Shqipëri, B&H, Maqedoni, Serbi); përdorim të reklamave qeveritare apo reklamave të partive politike për të financuar mediat që janë pro qeverisë, nga njëra anë (B&H, Maqedoni) dhe përdorim të inspektimeve tatimore dhe zbatim të pabarabartë të ligjit për të kërcënuar mediat që janë kritike ndaj qeverisë, në anën tjetër (B&H, Maqedoni, Turqi); përdorim të legjislacionit kundër terrorizmit për të censuruar dhe ndjekur penalisht gazetarë dhe aktivistë (Turqi); dhe kooptimi i OSHC-ve për të promovuar interesat e qeverisë (Shqipëri, Maqedoni, Serbi). Lidhur me median në veçanti, situata është më kritike në Turqi, ku së fundmi ka pasur burgosje të gazetarëve mbi bazën e akuzave të rreme, kufizime të shërbimit të internetit, kufizime për gazetarët e huaj, dhunë ndaj personelit mediatik dhe në ambiente mediatike dhe ndryshime të menjëhershme të rregulloreve për mediat. Megjithatë, sektori i medias në të gjitha vendet karakterizohet nga kontrolli i rreptë i qeverisë dhe ndërhyrje të jashtme dhe vetë-çensurim, të cilat e minojnë aftësinë e medias për të vepruar si rojtare (watchdog) e pavarur dhe e paanshme⁵¹.

Nëpunësit e marrëdhënies me publikun duhet të pranojnë detyrimin profesional të gazetarëve për të verifikuar informacionin dhe për të kërkuar burime të ndryshme të tij. Kërkimi dhe publikimi i informacioneve të siguruara nga burime alternative që ndonjëherë mund të jenë edhe të kundërta me deklaratat zyrtare të policisë, duhet të tolerohen dhe nuk duhet të përbëjnë shkak për diskriminim në të ardhmen për dhënien e informacioneve gazetarit ose medias në fjalë.

Në këtë situatë dhe për shkak të konkurrencës midis medieve elektronike a të shkruara, vihet re një fenomen i cili ka mbërthyer jo vetëm ato, por edhe opinionin publik me lajmet e kronikës së zezë. Nën efektin e sloganit “lajmi më parë kalon tek ne”, disa institucione mediatike mbushin rubrikat me lajme të gjithfarëllojshme, të verifikuara apo të paverifikuara,

⁵¹Luftimi i korrupsionit në vende e Ballkanit Perëndimor-Transparency International-Projekt i UE-së

të qarta ose jo dhe në disa raste edhe pa pyetur fare për privatësinë e personave të përfshirë nga lajmi. Mediet natyrisht kanë të drejtë të informojnë opinion publik, ky është misioni i tyre, por shpesh ato nuk mbajnë parasysh Kodin Etik të gjithë pranuar prej tyre, ekranet apo gazetatat “bombardohen” nga kronika e zezë.

Në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës dhe me parashikimet e bëra në nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte veçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për mbrojtjen e rendit, ose e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Praktika e ndjekur në vende të tilla si Italia apo Franca, përcakton qartë se: “publikimi i fotografive dalluese është i lejueshëm vetëm për qëllimet e drejtësisë ose ato policore” dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, që nga publikimet në internet dhe në rrjetet televizive, ku jepen sekuenca pamore nga kërkimet ose arrestimet e personave të hetuar për terrorizëm ndërkombëtar, për krime lufte etj. Ndodh dhe publikimi i pamjeve vizive të personave të dyshuar për prishje të rendit publik, trafikut të drogës dhe qenieve njerëzore, rrjeteve mafioze, pastrimit të parave, nga ana e medieve vizive, por vetëm për qëllime gazetarie.

Nga ana tjetër, e drejta për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion ushtrohet nga masmedia, roli i së cilës në informimin e publikut për çështje të interesit publik është mjaft i rëndësishëm. Por, duhet pranuar se standardet etike dhe kodet e sjelljes të profesionit të gazetarisë janë çështje të profesionistëve të medias dhe jo të fushës së legjislacionit.

Në dhënien e informacionit për publikun, parimi bazë për shërbimet policore, duhet të jetë transparenca dhe hapja ndaj publikut. Qëllimi duhet të jetë dhënia e informacionit të plotë dhe në kohë optimale për media dhe publikun, rreth të gjitha aspekteve të punës së policisë, por sidomos në lidhje me punën e saj për zbulimin dhe parandalimin e krimit si dhe ruajtjen e rendit publik. Dhënia e informacionit duhet të bazohet në legjislacionin për lirinë e informimit, rregulloret e brendshme, kode të ndryshme si dhe në kërkesa të tjera për hapjen ndaj publikut duke u interpretuar në bazë edhe të standardeve më të larta evropiane dhe ato ndërkombëtare.

Informacioni duhet t’u jepet medieve qoftë paraprakisht, por edhe me kërkesë të tyre, në forma të ndryshme si: njoftime, komunikata për shtyp, apo dhe konferenca shtypi. Sidomos roli i zëdhënësit të policisë duhet të jetë i pranueshëm në çdo kohë për t’u përgjigjur pyetjeve

të medias dhe të ndihmojë duke dhënë informacione të plota dhe në kohë rreth punës së policisë.

Legjislacioni i lirisë së informimit duhet të ketë gjithmonë përparësi ndaj ligjeve dhe rregulloreve qeveritare për klasifikimin e informacioneve në të cilat do të përfshihen ligje për sekretin shtetëror, të cilat klasifikojnë informacionet mbi bazën e sigurisë kombëtare, kode të ndryshme procedurale për ruajtjen e sekretit të hetimeve, ligje për mbrojtjen e të dhënave⁵² etj.

⁵²Konferenca Ndërkombëtare e organizuar nga ABA – CEELI, Varna (Bullgari), Maj 2002.

4. Roli i policisë në parandalimin e veprës penale Keqpërdorimi të detyrës zyrtare

Roli i policisë dhe i prokurorisë në zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale kundër integritetit Policia është organ shtetëror që bën pjesë në sistemin e drejtësisë penale të një vendi. Roli i policisë brenda sistemit të drejtësisë është i pashmangshëm, pasi që siç thekson me të drejtë dr. Ejup Sahiti se në luftimin e kriminaliteti “policia gjendet e para në vijë të frontit”⁵³. Në zbulimin dhe ndriçimin e veprave penale kundër integritetit seksual, si një ndër format e kriminalitetit, roli i policisë është i pashmangshëm. Siç dihet policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe për sigurinë e rendit juridik. Policia ka përjetuar ndryshime dhe evoluime të mëdha në fazat e zhvillimit të saj. Kurse kërkimet më të reja të aktivitetit policor, si sektor i posaçëm i kontrollit shoqëror, tregojnë se aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin e parandalimit⁵³. Pra, nga kjo shihet se policia është e krijuar me ligj, vepron sipas ligjit e mbron atë duke mbrojtur të mirat e individit dhe shoqërisë në përgjithësi. Dihet mirëfilli se me paraqitjen e kriminalitetit si dukuri negative e shoqërisë kanë pasur edhe masat përkatëse të shoqërisë dhe të shtetit në mbrojtjen e vlerave nga format e ndryshme të sulimit kriminal. Natyrisht kuptohet, se në një shoqëri të organizuar dhe në shtet në përgjithësi janë të përcaktuara kompetencat dhe detyrat e organeve përkatëse të zbulimit, parandalimit, gjykimit, respektivisht të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi. Roli i organeve të drejtësisë penale, pra edhe i policisë në zbulimin dhe ndriçimin e këtij lloji të kriminalitetit është i pazëvendësueshëm. Procedura paraprake e organeve të policisë, që kryhet në bazë të dyshimit të bazuar ose nga fillimi i bazave të dyshimit, kuptohet si përpunim kriminalistikë. Përpunimi kriminalistik është tërësia e masave dhe veprimeve të planifikuara metodologjike që ndërmer policia në procedurën paraprake lidhur me veprën penale ose ngjarjen penale, me qëllim që bazat e dyshimit deri ku është arritur me kontrollimin kriminalistikë të ngrihen në shkallë më të lartë të besueshmërisë, që do të mundësojë marrjen e vendimeve të caktuara penalo-juridike⁵⁴. Ç’është e vërteta, është e nevojshme që bazat e dyshimit me përpunim kriminalistikë të transformohen në dyshime të bazuara. Në përpunimin kriminalistikë bëjnë pjesë: masat dhe veprimet që ndërmerren për

⁵³E. Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.

⁵⁴V. Latifi, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2006.

zbulimin e veprës penale dhe kryerësit, që kryerësi dhe bashkë-vepruesi të zbulohen dhe të kapen, që të pengohet ikja dhe fshehja e tyre, që të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët dhe lëndët e veprës penale që mund të shfrytëzohen si prova në procedurën penale, që të mblidhen të gjitha informacionet me interes ose të dobishme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Ndërmarrja e veprimtarisë operative nuk varet nga kërkesa e prokurorisë kompetente ose nga ndonjë kusht tjetër formal, por fillon sipas vetiniciativës së policisë. Shkaku për ndërmarrjen e kësaj veprimtarie është të mësuarit për dyshimin e bazuar se është kryer vepra penale, për të cilën ndjekja bëhet sipas detyrës zyrtare⁵⁵. Fjala është për veprimtarinë e policisë që është e drejtuar në zbulimin, mbledhjen, sigurimin dhe nxjerrjen e provave mbi fakte relevante, zbulimin e kryerësit dhe sigurimin e pranisë së tij në këto procedura. Nga kjo që u tha mund të konstatojmë se roli i policisë, i prokurorisë, paraqet një veprimtari të dobishme, në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, po ashtu në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, duke ndërmarrë masa dhe veprime konkrete në zbulimin, parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, por edhe të kriminalitetit seksual. Në ushtrimin e detyrave të veta policia duhet të demonstrojë etikë, profesionalizëm, dhe integritet, sepse ato posedojnë pushtet të veçantë për të hequr përkohësisht lirinë e qytetarëve, të kufizojnë liritë dhe të drejtat e tyre, dhe në rrethana të veçanta të përdorin edhe forcën. Prandaj punonjësit e policisë këto detyra duhet t'i përmbushin në harmoni me standardet universale mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtave politike. Kudo në botë policia është nën presionin e luftimit të kriminalitetit, dhe kërcënimeve që i kanosen sigurisë ndërkombëtare dhe kombëtare nga ai. Megjithatë, policia është e obliguar të operojë në përputhje me ligjet vendore, dhe standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Legjislacioni dhe rregulloret që rregullojnë detyrat dhe veprimtarinë e policisë duhet të jenë të qarta, të sakta, dhe të hapura për publikun, sepse vetëm atëherë do të mbyllim mundësinë që policia të abuzoj dhe t'i tejkalojë kompetencat e veta, të cilat tejkalime do të ishin në dëm të lirive dhe të drejtave të njeriut. Policia në çdo rast është e detyruar të zbatojë ligjin pavarësisht nga pozita shoqërore, apo përkatësia politik e një të dyshuar.

⁵⁵Ministria për punë të brendshme e Republikës së Maqedonisë.

Kodi Etikës së Policisë së Shtetit duhet të reflektojë realitetin. Kritikët e kodeve të etikës, i qendrojnë pikëpamjes se kodet e shkruara pa orientim praktik apo që nuk reflektojnë realitetin, janë të pajetë. Njëkohësisht, në mënyrë që të jenë sa më shumë funksionalë, kodet duhet të shoqërohen me shembuj të sjelljes etike. Më konkretisht, etika në policim nuk duhet të jetë vetëm “Bibla e Sjelljes” e cila tregon sesi: Duhet, Mund, Është e Detyrueshme. Dokumenti i Kodit të Etikës, duhet të shërbejë si pasqyrë e parimeve dhe vlerave që shërojnë deformimet apo keqtrajtimet e ushtrimit të policimit, konform parimeve universale, si edhe të plotësojnë vakumet e reflektuara nga studimet e realizuara.

Etika ka një rol parësor në administratën publike. Nëse etika nuk mbetet vetëm një parim i shkruajtur në letër por arrin të zbatohet nga punonjësit e administratës publike atëherë në vend do të kemi një administratë e cila i ofron publikut të saj shërbimin më të mirë duke iu gjendur gjithmonë pranë atij⁵⁶.

Është e nevojshme që punonjësit e policisë të njohin nga afër parimet dhe vlerat që udhëheqin punën e policisë në mënyrë që ata të përgatiten për një policim modern: jo vetëm mbrojtjen e publikut, por sidomos kontrollin e sjelljeve. Marrja e informacionit nga punonjësit e policisë mbi zbatimin e etikës duhet t’i paraprijë trajnimit teknik në mënyrë që të lejojë kontekstualizimin e punës së tyre bazuar në një sërë vlerash të reja (parandalimi, aftësia për të dëgjuar, ndihma reciproke, etj.).

Edukimi në vazhdim është gjithashtu prioritar. Ndërtimi i një policie me etikë dhe integritet nuk përfundon me shkollimin bazë. Kjo në parim është e pranuar dhe janë krijuar hapësira për të pasur komponentë të edukimit në vazhdim edhe për policinë e Republikës së Maqedonisë. Nga ana tjetër, rezulton se këto hapësira herë janë të pakta, herë të paidentifikuara mirë si dhe shpesh të keq-shfrytëzuara duke u fokusuar më shumë tek procesi dhe dokumentet planifikuese për rekorde sesa një vlerësim dhe planifikim të bazuar në evidenca dhe të monitoruar për sa i takon zbatueshmërisë dhe rezultateve të arritura.

Duke marrë parasysh prezencën e korupcionit dhe pasojat e saj të dëmshme për sistemin politik, ekonomik dhe policorë, duhet të formohet një doktrinë dhe strategji e veprimit për zbutjen dhe ndalimin e saj, dhe e cila do të kontribuojë rezistences më të madhe të sistemit policorë dhe të shoqërisë në përgjithësi.

⁵⁶IDM, Tiranë 2014 / Kodi etik i Policisë së Shtetit Shqiptar.

KAPITULLI IV-të

1.Pasqyrë statistikore për territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për veprën penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare.

Shënim :

Gjykata e Apelit në Gostivar në bazë të nenit 353 nga Kodi Penal në lidhje me zbatimin dhe zgjidhjen e lëndëve për vepër penale Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimeve për periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2016 ka regjistruar 225 lëndë përmes ankesave edhe atë 162 lëndë përmes regjistrit për ankesa penale, 54 lëndë ankesa përmes Këshillit Penal dhe 9 lëndë përmes PN⁵⁷.

Tabela në vijim për numrin e lëndëve në Gjykatën e Apelit në Gostivar në bazë të nenit 353 nga Kodi Penal në lidhje me zbatimin dhe zgjidhjen e lëndëve për vepër penale Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimeve për periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2016.

Neni 353 nga Kodi Penal	Janë pranuar gjithsej	Regjistri i AP Ankesa penale	Regjistri i KAP Këshilli penal për ankesa	Regjistri i LD Regjistri për lëndë të ndryshme penale
Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve sipas nenit 353 nga Kodi Penal	225	162	54	9

Burimi : Statistika nga Gjykata e Apelit në Gostivar

Komente : Të dhëna statistikore arrita të siguroj prej vitit 2005-2016

Në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar gjithsej janë pranuar 225 lëndë prej të cilave 162 lëndë janë të regjistruara në regjistrin e Ankesave penale, 54 lëndë janë të regjistruara në regjistrin e Këshillit Penal dhe 9 lëndë janë të regjistruara në regjistrin për lëndë të ndryshme penale.

⁵⁷Tabelat statistikore të Gjykatës së Apelit në Gostivar për veprat penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve.

Tabela me të dhëna statistikore për vepra penale të zbatuara në Gjykatën Themelore në Gostivar për periudhën prej vitit 2005 – 2016⁵⁸, për vepër penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare”

Viti	Të pranuar	Të zgjidhura	Të tjera	Të plotfuqishme	Të ekzekutuara
2008	6	6	0	3	1
2009	15	15	0	8	1
2010	14	13	1	5	2
2011	19	18	0	8	2
2012	21	21	0	8	1
2013	22	19	3	6	2
2014	8	7	1	3	2
2015	11	9	2	3	2
2016	8	5	3	2	

Burimi : Statistika nga Gjykata Themelore në Gostivar

Komente : Të dhëna statistikore arrita të siguroj prej vitit 2008-2016.

Në Gjykatën Themelore Gostivar prej vitit 2008 – 2016 gjithsej janë pranuar 124 lëndë prej të cilave 113 janë të zgjidhura, 11 lëndë tjera, 44 të plotfuqishme dhe 13 të ekzekutuara.

Sipas të dhënave statistikore të kësaj gjykate rezulton se prej 124 lëndëve gjithsej të zgjidhura janë 113 lëndë që d.m.th. 91.1 % të lëndëve janë të zgjidhura, të tjera janë 8.8 %, të plotfuqishme janë 35.4 % dhe të ekzekutuara janë 10.4 %. Të njëjtat janë të prezantuara si më lart në lidhje me veprën penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare” sipas Kodit Penal në Republikën e Maqedonisë.

⁵⁸Tabelat statistikore të Gjykatës Themelore në Gostivar për veprat penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve.

Tabela me të dhëna statistikore për vepra penale të zbatuara në Gjykatën Themelore në Dibër për periudhën prej vitit 2005 – 2016, për veprën penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve⁵⁹” sipas nenit 353 paragraf 1 nga KP.

Viti	Gjithsej Lëndë	Nr. i të akuzuarve	Aktgjykimi		Aktvendime		Lloji i dënimeve	
			Të ref.	Gjykuara	Të pezulluara	Jokompetente	Me të holla	Me burg
2005	1	1	-	1	-	-	1	-
2006	1	1	-	1	-	-	1-6 muaj, masë alt., me kusht 2 vite	
2007	5	5	-	2	-	2	1	-
2008	2	2	1	1	-	-	1	-
2009	-	-	-	-	-	-	-	-
2010	3	3	-	-	2	-	-	1-4 muaj, masë alt., me kusht 2 vite
2011	1	1	1	-	-	-	-	-
2012	2	5	1	1	-	-	-	1-6 muaj, masë alt., me kusht 1 vite
2013	3	3	2	1	-	-	1	-
2014	-	-	-	-	-	-	-	-
2015	-	-	-	-	-	-	-	-
2016	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Statistika nga Gjykata Themelore në Dibër

Komente : Të dhëna statistikore arrita të siguroj prej vitit 2005-2016

Në Gjykatën Themelore Dibër prej viti 2005 – 2016 gjithsej janë pranuar 18 lëndë me gjithsej 18 të akuzuar prej të cilave me aktgjykim të refuzuara 5 lëndë kurse të gjykuara 7 lëndë, me aktvendim të pezulluara 2 dhe jokompetente 2, lloje të dënimeve me të holla 4 lëndë kurse dënime me burg në vitin 2006 janë shqiptuar prej 1-6 muaj masë alternative me kusht deri 2 vite, në vitin 2010 1-4 muaj, masë alternative me kusht deri 2 vite, në vitin 2012 1-6 muaj, masë alternative me kusht deri 1 vit.

Duke analizuar veç e veç shqiptimin e dënimeve sipas statistikave në Gjykatën Themelore në Dibër janë shqiptuar edhe dënime alternative.

⁵⁹Tabelat statistikore të Gjykatës Themelore në Dibër - Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve.

Tabela me të dhëna statistikore për vepra penale të zbatuara në Gjykatën Themelore në Tetovë për periudhën prej vitit 2010 – 2016, për vepër penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve⁶⁰” sipas nenit 353 paragraf 1 nga KP.

Viti	Me aktgjykim	Me kusht	Me aktvendim	Të pezulluara	Gjithsej
2010	4		2	3	9
2011	6	2	6	2	16
2012	12	1	7	0	20
2013	0	7	9	4	20
2014	5	8	2		15
2015	2	7		2	11
2016	0	2	4	4	10

Tabela me të dhëna statistikore për vepra penale të zbatuara në Gjykatën Themelore në Tetovë për periudhën prej vitit 2010 – 2016, për vepër penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve” sipas nenit 353 par.1 nga Kodi Penal. Me aktgjykim 29 lëndë, me kusht 27 lëndë, të pezulluara 15 lëndë, gjithsej që nga viti 2010 deri në vitin 2016 janë 101 lëndë.

Burimi : Statistika nga Gjykata Themelore në Tetovë

Komente: Të dhëna statistikore arrita të siguroj prej vitit 2010-2016

Në Gjykatën Themelore në Tetovë ne periudhën kohore 2010-2016 gjithsej janë pranuar 101 lëndë prej të cilave në vitin 2010 8.9 %, vitin 2011 15.8 %, vitin 2012 19.8 %, vitin 2013 19.8%, vitin 2014 14.8 %, vitin 2015 10.8 % dhe vitin 2016 9.9 % që rezulton se gjatë viteve 2012 dhe 2013 janë pranuar më së shumti lëndë për veprën penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare”

⁶⁰Tabelat statistikore të Gjykatës Themelore në Tetovë për veprat penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve.

Tabela me të dhëna statistikore për vepra penale të zbatuara në Gjykatën Themelore në Kërçovë për periudhën prej vitit 2009 – 2016, për vepër penale “Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve⁶¹” sipas nenit 353 paragraf 1 nga KP.

Sipas këqyrjes në seksionin penale të Gjykatës Themelore në Kërçovë, janë pranuar dhe vërtetuar gjithsej numri i lëndëve si në vijim :

Për vitin 2009	-	9 lëndë
Për vitin 2010	-	15 lëndë
Për vitin 2011	-	8 lëndë
Për vitin 2012	-	9 lëndë
Për vitin 2013	-	5 lëndë
Për vitin 2014	-	3 lëndë
Për vitin 2015	-	3 lëndë
Për vitin 2016	-	7 lëndë

Për vitin 2017 nga 01.01.2017 deri me datë 19.10.2017 janë pranuar dhe vërtetuar 2 lëndë.

Burimi: Statistika nga Gjykata Themelore në Kërçovë

Komente : Të dhëna statistikore arrita të siguroj prej viti 2009-2016.

Në Gjykatën Themelore Kërçovë prej viti 2009 – 2016 gjithsej janë pranuar 59 lëndë prej të cilave nuk arritëm të sigurojmë të dhëna të sakta sa lëndë janë të zgjidhura sa të pezulluara etj.

Sipas analizës në statistikat si më lart rezulton se gjatë vitit 2010 numri i lëndëve të pranuar është dukshëm më i madh në krahasim me vitet tjera.

⁶¹Tabelat statistikore të Gjykatës Themelore në Kërçovë për veprat penale Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimeve.

2. Analizë e aktgjytimeve

Kualiteti i vendimeve gjithashtu është i treguar i rëndësishëm si çka qenë rasti edhe me perfaqësimin.

Në lëndën P.nr.532-08 për shkak të bashkëpunimit të mëparshëm mes gjykatës dhe të akuzuarit si kryerës i funksionit publik, gjithashtu edhe me prokurorin publik, si funksione që i kanë vënë në pozitë të ngushtë për të bashkëpunuar dhe sigurisht edhe njohja e tyre shumëvjeçare, gjatë tërë procedurës vëshguesit mund të shohin pjerërish, me indikacione se për shkak të këtyre lidhjeve do të vendoset aktgjykim për ta liruar. E gjithë kjo posaçërisht kur PPTH e ndërroi aktakuzën nga Ndërmjetësimi kundër ligjor në Mashtrim⁶². Lirimi nga akuza në lëndën konkrete ka qenë për shkak të mosvërtetimit të fajit nga ana e të akuzuarit, vëshguesit supozojnë se gjykata ka treguar besim më të madh në deklaratat e dëshmitarëve të marrë në pyetje që janë shokë të përafërt me të akuzuarit sesa me të dëmtuarin. Kështu që rasti përfundoi me aktgjykimin e lirë në vend të aktgjykimit në bazë të dëshmimeve të nxjerra.

Në lidhje me lëndët e përfunduara, mund të konstatojmë se nga gjithsej 1101 ëndë të vëzhguara në 303 seanca procedura është e përfunduar në 39 lëndë. Nga vetë shqyrtimi i dobët i këtyre numrave me domosdoshmëri imponohet përfundimit tejet i dukshëm se në numrin më të madh të lëndëve të vëzhguara procedura zgjat më tepër se një vit. Në këtë rast duhet të përmendet se vetëm në 7 raste të Prokurorit publik e ka tërhequr akuzën, me të cilën procedura është e përfunduar me aktgjykim i cili kundërshton akuzën, kjo duke pasur parasysh faktin në procedurat e vëzhguara pas fillimit të shqyrtimit kryesor. Aktgjykim material, respektivisht i merituar është marrë në 32 lëndë. Këtë rast mund të konstatojmë se Gjykatat Themelore në Strumicë dhe Veles zgjodhën më shumë lëndë dhe atë 13, respektivisht 8 në mënyrë adekuate, prej të cilëve 10, respektivisht 6 janë me aktgjykim të merituar. Në gjysmë është gjykata Themelore në Kavadar me lëndë vëzhguese gjysmë të zgjedhura e më pak lëndë të zgjedhura në gjykatën Themelore Shkup 1 me vetëm dy prej gjithsej 22.

Kuptohet duhet pasur parasysh kompleksiteti i lëndëve të cilat procesohen në këtë gjykatë dhe prej këtu dhe nevoja për më shumë kohë gjatë marrjes së aktgjykimit. Në Gjykatën Themelore në Ohër janë të zgjedhura 2 lëndë nga gjithsej 8 të vëzhguara.

⁶²Nikolloska, S. - Veprat penale kundër detyrës zyrtare., Shkup, 2008.

Mund të konstatohen se prokurorët publik rrallë japin dorëheqje nga akuza, përkatësisht e shprehur nëpërmjet numrit të lëndëve të vëzhguara në më shumë lëndë të vëzhguara dorëheqje në kanë dhënë Manastir, në të vërtetë në 1 nga gjithsej 4 lëndë të zgjedhura, e ngjajshme është situata edhe në Strumicë (me 3 lëndë nga gjithsej 13) përderisa sipas përjashtimit dorëzohen në Veles (me 2 prej 8 të zgjedhura dhe në Koçan me një lëndë të zgjedhur nga 7). Në gjykatat tjera mund të konstatohet se prokurorët publik kanë qenë të sukseshëm në lidhje me prezentimin e fakteve me të cilat i kanë ngarkuar të akuzuarit për veprat e kryera penale. Nëse e shqyrtojmë politikën ndëshkuese sipas veprave penale mund t'i fitojmë shqyrtimet në vijim. Pikërisht, më tepër aktgjykime janë marrë, kuptohet për veprat më frekvente penale, respektivisht për veprën e nenit 353 nga KP-Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizim⁶³. Me ç'rast nga të gjitha aktgjykimet për 45 persona të akuzuar, ku në të vërtetë janë marrë aktgjykime për 29 persona. Njëherë duhet të përmendet se nga këta 29 persona për fajtorë janë shpallur vetëm 9, përderisa 11 persona të akuzuar, akuza ka qenë e refuzuar, për 5 të akuzuar prokurori publik e ka tërhequr aktakuzën e vetëm 3 të akuzuar kanë marrë aktgjykim të lirë. Në lidhje me personat me aktgjykim mund të konstatohet politika ndëshkuese mjaft e ulët, respektivisht 7 të gjykuar kanë marrë dënim në kohëzgjatje prej 1 viti e gjysmë, përkatësisht për një të gjykuar i është shqiptuar dënim me burg 3 mujor, 3 të gjykuar kanë marrë dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve dhe gjykatat nga një personi u kanë shqiptuar burgim në kohëzgjatje prej 10, 12 dhe 18 muaj. Dënime më të rrepta kanë marrë dy persona në kohëzgjatje prej tri vjet dhe dënimi më i rreptë i është shqiptuar një të akuzuari në kohëzgjatje për katër vite. Konform këtyre të dhënave mund të konstatojmë se një personit i është zbutur dënimi nën minimumin e posaçëm ligjor për këto vepra, derisa numri më i madh i dënimëve lëvizin në kuadër të gjysmës së fundit të minimumit të veçantë ligjor, minimum ose maksimum i paraparë për veprën penale (prej 6 muajve deri në 3 vjet), derisa vetëm 3 personave u janë shqiptuar dënime më të larta, qoftë dënimi më i madh për veprën kryesore ose në këto raste është bërë fjalë për ndonjë nga format e kualifikuara të të kësaj vepre, me të cilën nëse është bërë fjalë për formë të kualifikuar të veprës kryesore, atëherë gjykata përsëri ka treguar lehtësi të posaçëm ndaj këtyre veprave penale. Më tutje, përsëri kësaj vepre penale më tepër të akuzuar ka për veprën penale Mashtrim, përkatësisht

⁶³Me kriminalitet ekonomik i kuptojmë të gjitha ato format e aktivitetit kriminal që janë të drejtuara kundër sistemit ekonomik dhe funksionimit të tij, pavarësisht se a janë të ndërmarra në kuadër të afarizmit ekonomik apo jashtë tij.

aktgjykime kanë marrë 7 persona, prej të cilëve me aktgjykim dënues, kanë qenë 5 të akuzuar, një i akuzuar ka marrë aktgjykim lirues, ndërsa për një të akuzuar ka qenë e tërhequr akuza. Në raport me politikën ndëshkuese për veprën penale mashtrim për të cilën për formën kryesore mund të shqiptohet dënim në të holla ose dënim me burg deri më 3 vite mund të konstatojmë se dy të akuzuar kanë qenë të akuzuar me dënim relativisht të ulët prej gjashtë muaj, dy të akuzuar kanë marrë vlerën e mesme të dënimit të paraparë për këtë vepër penale, përkatësisht tetëmbëdhjetë muaj dhe vetëm një person ka qenë i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 vite. Përqindja më e mire e suksesit ndaj paditësit të autorizuar kanë pasur te vepra penale mitë marrje nga neni 357 nga LVP, për të cilën për formën kryesore është paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej një deri dhjetë vite, në pajtim me ndryshimet e KPM nga shtatori i vitit 2009 parashihet ashpërsim në këtë vepër penale kështu që është e paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej së paku katër vite deri në dhjetë vite për këtë vepër penale, njëherit është shqiptuar edhe dënimi më i lartë i lëndëve të vëzhguara përkatësisht 5 vitet derisa për nga një të akuzuar është shqiptuar dënim në kohëzgjatje dhjetë vite, 2 dhe 3 vite. Për veprën penale Vjedhje në shërbim nga neni 354 kanë qenë të përfunduara procedurat kundër tre prokurorëve prej të cilëve dy ishin të shpallur për fajtor dhe u është shqiptuar dënimi me kohëzgjatje prej gjashtë deri në 12 muaj ndërsa 1 i akuzuar ka marrë aktgjykim të lirë. Nga 1 person i gjykuar ka qenë edhe për veprat penale Mashtrim të blerësve nga neni 248 i KPM dhe dëmtim ose privilegjim të kreditorëve nga neni 257 të KPM në rastin e parë të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj, ndërsa në rastin e dytë të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muaj. Në lidhje me politikën ndëshkuese të gjykatave, mund të jepet një konstatim gjeneral që pa përjashtim vlen për të gjitha veprat e vzhguara penale, ajo është se gjykatat kanë politik lehtësuese të ndëshkimit e cila mesatarisht lëviz në kuadër të gjysmës së fundit të dënimit të paraparë ligjor për vepër të caktuar penale. Neni 6 nga Konventa Evropiane kërkon që Gjykatat Kombëtare të arsyetojnë aktgjykimin e tyre si gjatë procedurave civile ashtu edhe atyre penale⁶⁴. Gjykatat nuk janë të obliguara të japin përgjigje detajuese në çdo pyetje, por nëse dëshmitë e paraqitura janë teje të rëndësishme për rezultatin e lëndës, në atë rast gjykata duhet konkretisht t'i përpunojë në aktgjykimin e vetë.

⁶⁴Neni 6 nga Konventa Evropiane për Gjykata Kombëtare.

Gjykatat janë atë detyrë shumë detajisht e përshkruan, kështu që gjykatësit ndonjëherë e ndjejnë si ngarkim të madh. Mendimi i përgjithshëm i vëzhguesve është se detyra e gjyqësorit për arsyetim të vendimit është e domosdoshme për funksionim të drejtë të dispozitave për vlerësim të lirë të dëshmive tek të cilët e ka kuptimin e objektivitetit të atij vlerësimi, përkatësisht mbrojtja prej gabimeve dhe vetë dëshirës së gjykatës në atë veprimtari *De lege ferenda* detyra për arsyetim të aktgjykimeve mund të ne të përshtatet me parimin e ekonomizimit, kështu që parimisht lidhet me iniciativën e paditjes së pales, gjykata do të ishte e detyruar të përpunojë arsyetim të gjithanshëm vetëm nëse palët e lajmërojnë ankesën e tyre në afat të caktuar pas shpalljes së aktgjykimit.

Një arsyetim fundamental e moral për kërkesën për procedurën ndëshkuese të drejtë është ajo se e minimizon numrin e gabimeve, përkatësisht trajtimet jo të drejta. Në atë masë në të cilën kërkohet procedura e saktë gjyqësore, përmbushtet moralisht funksionimi i vlerave për minimizim të gabimeve në procedurën ndëshkimore, sepse jepet garanci se numri i dënimeve të padrejta do të jetë aq i vogël aq sa është e mundur ajo dhe jep besim se ata që janë të ndëshkuar atë e meritojnë. Garancitë teorike përfshijnë atë që i akuzuari t'i gëzojë të gjitha instrumentet ndërkombtare për të Drejtat e njeriut dhe Kushtetutën e R.së Maqedonisë, që është supozim për pafajësi. Ky supozim zakonisht gjen shprehje në parimin se faji i tyre duhet të dëshmohet "Jashtë çfarëdo qoftë gjykimi". Ekzistojnë dy aspekte themelore të kësaj rregulle, e ajo është kërkesa për standard relativisht të lartë të dëshmimit nga njëra anë dhe vënia e ngarkesës së dëshmive mbi prokurorinë nga ana tjetër⁶⁵. Standardi për të cilin flasim përpiqet për të bërë kompromis mes dy qëllimeve kundërshtuese, që i akuzuari të gjykohej ndërsa i pafajshmi të lirohet, njëkohësisht duke shprehur përparësi për lirimet e gabuara para gjykimeve të gabuara. Një kohë më të gjatë procedura janë nga i a.q. tip i përzier kritikohet si aspekt joadekuat në respektimin e supozimit të pafajësisë si parim qendror i drejtësisë bashkëkohore penale. Së pari, ngarkesa e dëshmimit bie mbi gjykatën, se sa mbi prokurorinë publike dhe e dyta, standardi i dëshmimit në mënyrën eksplicite nuk thirret në standardin "jashtë çdo dyshimi të arsyeshem" në të cilin insistohet në të drejtën ndërkombëtare dhe vendet me procedurë akuzatore të tipit anglosakson.

⁶⁵E drejta e procedurës penale në R.M., Ejup Sahiti/Ismail, Zejneli, Shkup, 2017.

Përkundër këtyre pohimeve në literaturën e vendit dhe atë të huaj, vlerësimet e vëzhguesve janë se në numrin më të madh të rasteve është arritur sukses i lartë i bindshmërisë në drejtësinë e vendimeve për fajësi (97%), që mes tjerash është njëra nga befasishtë më të pranishme të rezultateve të fituara nga projekti.

- Në numrin më të madh të lëndëve të vëzhguara ka pasur gjykim të drejtë – mundësi e drejtë për tu mbrojtur nga akuzat. Me disa përjashtime (ku është gjykuar në mungesë) të njëjtat kanë qenë të mara në pyetje dhe kanë pasur mundësi adekuate dhe efektive për të qenë prezent gjatë shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykatat e vendit kanë zbatuar analizim të drejtë të argumenteve dhe dëshmive të nxjerra nga anët dhe nuk kanë pasur paragjykim gjatë vlerësimit të tyre. Njerëzit më tepër i pranojnë vendimet nëse të njëjtat janë të arritura në procese që janë vlersuar si të drejta, drejtësia e procesit vlersohet pavarësisht nga drejtësia e rezultatit monitorimet treguan se për personat në proces, e drejta procedurale paraqet nivel të ndryshëm të përjetimit në raport me rezultatin. Rezultati përfundimtar prapëprap luan rol kyç në vlerësimin që ka qenë i drejtë. - Në veprimet penale në rastet e korrupsionit intereset pragmatike të shtetit anojnë në dënimin e të akuzuarve dhe për anashkalim të përpjekjeve dhe shpenzimeve më të mëdha. Monitorimi i veprimeve dhe shoqërimi i standardeve që gaarantojnë drejtësinë pikërisht për atë janë të nevojshme për mbrojtje të interesave të ndieshme të të akuzuarve, duke ju siguruar aq sa është e mundur që ato të mos akuzohen, përveq nëse nuk janë vërtetë fajtor. KVP nuk e parashtron problemin e ekspedivitetit si e drejtë e të akuzuarit por si obligim i subjekteve të procesit. Forma e pacaktuar e obligimit nga njëra anë e relativizon punën e gjykatës si nxitës i ekspedivitetit dhe nga ana tjetër e bëjnë absolute atë ekspedivitet, duke bërë nga ajo kualitet që nuk është disjunktiv ose komplementar me vlera tjera të procesit. Ky obligim kështu i formuluar publikisht i drejtë i gjykatës synon kah efikasiteti formal, në një mënyrë të caktuar më tepër i obligon subjektet tjera të procesit se sa vet gjykatën. Në Republikën e Maqedonisë më i shpeshtuar është korrupsioni që paraqitet në formën e keqpërdorimit dhe shfrytëzimit kundërligjor të detyrës zyrtare dhe autorizimit që dalin nga ajo, për dallim nga deliktet tradicionale korruptive⁶⁶. Prokurorët publik rrallë dorëzohen nga akuzat. Në lidhje me zbatimin e masave të posaçme hetimore mbahet kostatimi i vitit të kaluar se këto masa të posatshme hetimore përdoren në numer mjaft restriktiv. Gjatë shqyrtimit të masave për sigurim të prezncës gjatë veprimeve së

⁶⁶Ismail, Z. - Disa karakteristika të korrupsionit dhe pengimi i tij, Tetovë, 2009.

bashku, pa masën e para burgimit, implementohet në numër tejet të vogël në raport me masën e paraburgimit. - Përveç paraburgimit masat tjera gjejnë përdorim në situatë të rralla ose të jashtëzakonshme. - Në raport me masat tjera për sigurim të presencës së të akuzuarit, paraburgimi është larg implementimit si masë për sigurim të presencës së akuzuarit.

Në lidhje me kohëzgjatjen e masës së paraburgimit mund të përderisa në 28.6% të rasteve periudha deri në caktimin e séances ka qenë ndërmjet 270 dhe 360 ditë, e në 16% mbi 360 ditë. - Arsytet për anulim të lëndëve kryesisht regjistrohen në thirrjen e dëshmitarëve të rid he grumbullimin e dëshmime materiale e një numër shumë i madh i lëndëve janë të anuluar për shkak të mungesës së të akuzuarit. Më tepër lëndë anulohen në Shkup, pastaj në Veles, Strumicë dhe Manastir, derisa më pak anulime vërehen në gjykatën themelore në Ohër. Dobësi më e madhe në hetim është kohëzgjatja, grumbullimi jo adekuat i dëshmime dhe përsëritja e ngjarjeve. Kohëzgjatja e hetimit problematizohet në veçanti me rastet e paraburgimit, për zvaritjen e hetimit paraqiten raportet e jokoordinuara mes policies, prokurorisë publike dhe gjykatës. Vetë prokuroria si institucion varet nga MPB sepse nuk ka kapacitetet e saja hetimore, për derisa hetimi gjyqësor sipas rregullës i përsërit marrjet në pyetje të personave më parë të marrë në pyetje nga policia dhe prokurorët publik dhe nuk kontribon në mbledhjen e dëshmime dhe vërtetimin e gjendjes faktike⁶⁷. Vështirësitë e procesit me gjykatësit e jurisë dalin nga mospërgaditja dhe pasiviteti gjatë gjykimit si dhe mosrezistenca ndaj ndikimeve të jashtme.

Në kuptim të organizimit pjesmarrja e tyre e vështirëson punën e gjykatës sepse ata shumë shpesh nuk përgjigjen e gjykatës.

⁶⁷Me definicionin korrupsion i formuar në kuadër të projektit “Vlerësim i nevojës për zhvillim të programës për vëzhgimin e procedurave gjyqësore në lidhje me korrupsionin në Republikën e Maqedonisë”, i realizuar gjatë vitit 2007 janë të përfshira 24 vepra penale dhe atë Mito gjatë zgjedhjeve dhe votimeve Mashtrim, Mashtrime të blerësve, Marrje e paautorizuar e dhuratave, Falimentim i rrejshëm, Nxitje e falimentimit, Kryerje e detyrës në mënyrë të pandërgjegjeshme, Keqpërdorim të procesit për falimentim, Dëmtim ose autorizim të kreditorëve, Pastrim parash dhe prodhime tjera të veprave ndëshkuese, Mashtrim gjatë punës me letra në vlerë dhe pjesëmarrje, Dhënia dhe furnizimi i pa autorizuar i fshehtësisë së punës, Keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit, Shpërdorim të shërbimit Mashtrim në shërbim, Shërbim në detyrë, Marja e ryshfetit, Dhënia e ryshfetit, Ndërmjetësim jashtëligjor, Fshehja e prejardhes jo proporcionale e pronës, Dhënie të fshehtësisë zyrtare, Keqpërdorim të fshehtësisë shtetërore, Të shërbimit ushtarak, Falsifikim i dokumenteve zyrtare, Arkëtim dhe pagim jashtë ligjor dhe ndikim jashtë ligjor ndaj dëshmitarëve.

KONKLUDIM

Pozita zyrtare është një pasqyrim i vërtetë i shtetit. Në diversitetin e saj, ajo përfaqëson një sistem brenda të cilit mbështetet siguria e rendit juridik si dhe shoqëria në tërësi. Shoqëria, përmes shërbimit të duhur dhe legjitim, fiton linjat thelbësore të portretit të saj. Kështu, çdo shkelje e rregullsisë dhe ligjshmërisë së shërbimit mund të jetë edhe një njollë e vogël, por shumë e madhe dhe e rëndësishme në atë portret. Krimi është jashtëzakonisht i rrezikshëm në qenien e saj. Aq më shumë kur ai shkon pa u ndëshkuar ose është i pavëmendshëm. Në shumë raste, veprat penale kundër detyrës zyrtare shpesh shfaqen për arsye të theksuara në këtë tezë. Zyrtarët të cilët, të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe të ndërgjegjshëm për faktorët funksional-juridike të sistemit, në mënyrë për të arritur një përfitim personal, me qëllim kryejnë fshehjen e veprave penale. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që qëllimet e tilla duhet shkatërruar rënjisht, detyra zyrtare të pastrohet nga këto veprime të paligjshme, por, ama dhe të ngritet vetëdija për të gjitha personat përgjegjës në një nivel më të lartë. Kjo gjithashtu forcon sigurinë ligjore dhe besimin në shtetin ligjor. Korrupsioni është përmendur gjithashtu, fenomenologjia e të cilit është lëndë e shumë studimeve. Rëndësia e këtij fenomeni zhvendoset në nivel transnacional. Siç është thënë, është një murtajë moderne, nga e cila asnjë shoqëri nuk është immune.

Në të vërtetë, korrupsioni është sfidë e të gjithë personave zyrtarë dhe provë e tyre e përjetshme, në të cilën duhet të merret vendimi nëse kodi etik dhe ligji do të jenë në interes personal. Në të gjithë e dimë se interesi personal si pasqyrim i motiveve të ulëta, për fat të keq, atë betejë e fiton. Si një metodë e rëndësishme në zbulimin e korrupsionit dhe formave të tjera të veprave penale kundër detyrës zyrtare, përmenden edhe mediumet. Vetëm një instrument aq i fuqishëm elektronik mund të përqendrojë vëmendjen kolektive në rastet e mitos, shpërdorimit të detyrës dhe të tjerët. Për më tepër, janë të përpunuara gjitha manifestimet e këtyre krimeve, të përcaktuara në ligjin penal, të cilat tregojnë të gjitha format e mundshme të sulmeve të dhunshme në shërbimet legjitime. Këto forma janë të lidhura ngushtë dhe në praktikë ato shpesh kryhen në bashkëveprim. Ata janë pjesë e një tërësie, për të cilën autorët e krimit dhe bashkëpjesëmarrësit përpiqen që në kuptim të proceseve hetimore të mos jenë në agjendën e autoriteteve të ndjekjes penale. Për këto arsye koha, informacioni operativ dhe afati kohor janë çelësi i njohurive dhe ndriçimit të tyre.

Ligjërishit ushtrimi i detyrës zyrtare një pjesë e vogël e Katrorit Rubik, është vazhdimisht në lëvizje dhe ndryshon, me shpresën që të gjithë llojet e ngjyrave do t'i vendos - në njërën anë, në korrupsion organe imune policore, veçanërisht zyrtarë të saj; në të dytën një gjyqësor funksional, në të tretën një ekzekutiv ligjor, etj. Qëllimi kryesor i kësaj teze është që përveç qasjes teorike të veprave penale kundër detyrës zyrtare të jetë perceptimi dhe ndërgjegjësimin i arsytimit për rëndësinë e çdo veprave penale kundër detyrës zyrtare në mënyrë individuale. Jemi përpjekur për t'u përqendruar në diç që kurrë individualisht ose rastësisht nuk hequr një fije si në rrjetin e merimangës, e cila ka për synim të informojë të gjithë rendin ligjor, në mënyrë që fundja e njëjta të bëhet me interes personal dhe jo me një sistem të themeluar ligjërishit për mbrojtjen e interesave të përbashkët, ose më shkurtë, jetën e njerëzve në përgjithësi.

Pozita zyrtare është një pasqyrim i vërtetë i shtetit. Në diversitetin e saj, ajo përfaqëson një sistem brenda të cilit bazohet siguria e rendit juridik si dhe shoqëria në tërësi. Shoqëria, përmes shërbimit të duhur dhe legjitim, fiton linjat thelbësore të portretit të saj. Kështu, çdo shkelje e rregullsisë dhe ligjshmërisë së shërbimit mund të jetë edhe një njollë e vogël, por shumë e madhe dhe e rëndësishme në atë portret. Krimi është jashtëzakonisht i rrezikshëm në qenien e saj. Aq më shumë kur ai shkon pa u ndëshkuar ose është i pavëmendshëm. Në shumë raste, veprat penale kundër detyrës zyrtare shpesh shfaqen për arsye të theksuara në këtë tezë. Zyrtarët të cilët, të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe të vetëdijshëm për faktorët funksional-juridike të sistemit, në mënyrë për të arritur një përfitim personal, me qëllim kryejnë fshehjen e veprave penale. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që qëllimet e tilla duhet shkatërruar rënjësisht, detyra zyrtare të pastrohet nga këto veprime të paligjshme, por, ama dhe të ngritet vetëdija për të gjitha personat përgjegjës në një nivel më të lartë. Kjo gjithashtu forcon sigurinë ligjore dhe besimin në shtetin ligjor. Korrupsioni është përmendur gjithashtu, fenomenologjia e të cilit është lëndë e shumë studimeve. Rëndësia e këtij fenomeni zhvendoset në nivel transnacional. Siç është thënë, është një murtajë moderne, na e cila asnjë shoqëri nuk është imune.

Në përfundim të këtij punimi duhet konstatuar se korrupsioni zyrtar dhe veprat tjera kundër detyrës zyrtare janë jashtëzakonisht të rrezikshme për ardhmërinë e një vendi dhe shoqërie në përgjithësi, parandalimi dhe luftimi e këtyre veprave penale nuk ka alternativë, mirëpo është detyrim dhe obligim i cili kërkon ndërhyrje të shpejt nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore.

Historia e zhvillimit të shteteve sidomos shteteve që kanë kaluar ose janë duke kaluar fazat e tranzicionit tregojnë se korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare kanë qenë evidente në këto shoqëri, mirëpo qasja serioze institucionale, shtetërore ka ndikuar në ndryshimin e gjendjes në këto shtete dhe uljen e rasteve të veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Republika e Maqedonisë duke u bazuar në të gjitha raportet e organizatave joqeveritare të brendshme dhe ndërkombëtare tregojnë se korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare janë evidente. Raportet zyrtare të Progresit të nxjerra nga Komisioni Evropian tregojnë se niveli i korrupsionit dhe krimit të organizuar është një shqetësim serioz për shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Maqedonia dhe disa vende të Ballkanit Perëndimor si shtete në tranzicion duhet që luftën kundër korrupsionit të bëjë edhe më intensive, në institucionet publike të kërkohet llogaridhënie nga të gjithë përgjegjësit brenda institucioneve publike si dhe marrja e masave ndaj atyre që në forma të ndryshme bëjnë devijime në ushtrimin e autoritetit të tyre zyrtar ose duke tejkaluar kompetencat e tyre ligjore, duke e neglizhuar punën zyrtare në institucionet publike.

Në rekomandimet në përgjithësi, sipas mendimit të recenzentit L.Arnaudovski - Efikasiteti i sitemit gjyqësor në përballim me korrupsionin në Republikën e Maqedonisë, me rëndësi të veçantë janë ato të cilët tregojnë nevojën e thatë të ndjekjes dhe hetimit të dukurive të kësaj fushe, në mënyrë sistematike me metodologji adekuate të themeluar shkencëtarisht, kjo në veçanti për faktin që format e reja të kriminalitetit janë karakteristika e reja fenomenale që kërkojnë dituri dhe përvoja në veçanti në këtë kohë kur kryhen ndryshime dhe plotësime në ligjdhënien tonë ndëshkuese. Përfundimet dhe rekomandimet të cilat mes veti plotësohen sipas përmbajtjes dhe metodologjisë, janë të dhëna në sistem dhe shqyrtimi i tyre, notimi dhe pranimi duhet të realizohen me hyrje të njëjtë si një tërësi. Paraqitja grafike e rezultateve ndodhet në funksion të sqarimit të dukurisë dhe problemeve por edhe mbi mbështetjen e përfundimeve të nxjerra, konstatimeve dhe qëndrimeve. Qasja në analizë ka karakter të dyfishtë; çdo institut analiyohet dhe sqarohet në aspekt të funksionimit të tij praktik nëpërmjet legjislativës, por autorët njëkohësisht, si dhe qëndrimet e tyre i sqarojnë nëpërmjet pamjeve të tyre shkencore teorike të cilët janë në pajtueshmëri me pajtimet dominante teorike dhe shkencore në kuptimin bashkëkohor teorik të procesit penal. Këto analiza e vënë në funksion të ndryshimeve aktuale dhe vijnë në ligjdhënien tonë penale-procesuale.

BIBLIOGRAFIA

1. "Kodi penal i Republikës së Maqedonisë" Tekst integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, tregues alfabetik, Furkan ISM Shkup, 2015.
2. Kambovski V., "Kodi Penal në RM", (Tekst integral), Shkup, 2009.
3. Latifi V., "Kriminalistika" - zbulimi dhe të provuarit e krimit, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti juridik, Prishtinë, 2006.
4. Ligji për ndryshim dhe plotësim i Kodit penal të RM-së (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 80/99).
5. Muazam H., "Abuse of power and authority in Republic of Macedonia – form of economic crime" publikuar në revistën shkencore "The Macrotheme Review" 4(6)- 2015 v. Dubrovnik, 2015.
6. Muazam H., "Aspekte kriminologjike-kriminalistike në keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimeve në Republikën e Maqedonisë" ,Shkup, 2015.
7. Nikollovska, S., "Veprat penale kundër detyrës zyrtare", Disertacion doktore, Akademi policore, Shkup, 2008.
8. Sadin H., "Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit si formë e veçantë e kriminalitetit" Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Juridik, 2015.
9. Halili R., "Penologjia", Prishtinë, 2005.
10. Salihu I., "E drejta penale" - pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005.
11. Halili R., "Kriminologjia", botimi i gjashtë, Prishtinë, 2008.
12. Ismail Z., "E drejta penale" - pjesa e posaçme, Tetovë, 2008.
13. Ismail Z., : Disa karakteristika të korrupsionit dhe pengimi i tij, Tetovë, 2009.
14. Grup autorësh, "Kriminaliteti i organizuar", Tetovë, 2009.
15. Ejup S.& Ismail Z., : E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017.
16. Latifi V., "Politika kriminale" Prishtinë, 2008.
17. Salihu I., E drejta penale – pjesa e posaçme, Prishtinë, 2015.
18. Elezi I., E drejta penale – pjesa e posaçme, Tiranë, 2004.

19. Elezi I., “Mbi Kriminologjinë”, Tiranë 2005.
20. Kregar Josip., Strategjia kundër korrupsionit, Sarajevë, 2007.
21. Dean J. Ch., George E. Rush: Puna e policisë në bashkësi, Office of Public Affairs, Embassy of the United States of America, Sarajevo, 2003.
22. Modly D., Hyrje në kriminalsitikë, Sarajevë, 2004.
23. Grup autorësh Këshilli European dhe Komisioni European, Sarajevë, 2005.
24. Ismail Z., 2014, „Corruption as a form of Organized Crime”, Vol.4 No.2, January, Shkup.

I. Kode, Konventa dhe ligje

1. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
2. Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë
3. Kodi Penal i Republikës së Kosovës
4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
5. Kodi Penal i Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës
6. Kodi Penal i Republikës së Kroacisë
7. Kodi Penal i Republikës së Serbisë
8. Agjencia Kundër Korrupsionit
9. Revistë shkencore „Justinijani I“

II. Interneti

1. www.wikipedia.org
2. www.justice.gov.al
3. www.restorativejustice.org
4. www.pravda.gov.mk
5. www.stat.gov.mk
6. www.avokati i popullit.gov.al
7. www.wordpress.com